BASHKIA HAS



# Plani i Arsimit Parauniversitar
# 2026 - 2028

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

**Përmbajtja**


1. Hyrje dhe konteksti ... 6

Konteksti administrativ ... 6

Të dhëna demografike ... 7

Struktura e popullsisë së re dhe implikimet për Arsimin ... 7

Implikimet kryesore për ofrimin e shërbimeve arsimore janë: ... 8

Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor ... 8

2. Analiza e shërbimit të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2024 – 2025 ... 9

Shpërndarja dhe ofrimi i shërbimit të arsimit parashkollor ... 9

Frekuentimi në Arsimin Parashkollor ... 10

Tipologjia e godinave dhe kapciteti akomodues ... 10

Fëmijët me aftësi të kufizuara (AK) ... 11

Fëmijë me program mbrojtjeje individuale ... 11

Fëmijë nga komuniteti rom dhe egjiptian ... 11

Fëmijë që vijnë nga familje me ndihmë ekonomike ... 11

Fëmijë me status social tjetër (psh. jetim, me prindër emigrantë, etj.) ... 11

Burimet njerëzore në ofrimin e shërbimit të arsimit parashkollor ... 12

Numri total i mësueseve ... 12

Kualifikimi arsimor i mësueseve ... 12

Mësueset ndihmëse ... 12

Eksperienca e mësueseve ... 12

Infrastruktura e godinës së kopshtit dhe aksesueshmëria ... 13

Aksesueshmëria – Rampat në kopshte ... 13

Nevoja për rikonstruksion ... 13

Llojet e ndërhyrjeve dhe prioritarizimi i ndërhyrjeve: ... 13

Vetëm mobilieri ... 14

Pa nevojë për rikonstruksion (Gjendje e mirë) ... 14

Strukturat pjesëmarrëse dhe mbikëqyrëse në kopshte ... 14

Bordi i kopshtit ... 15

Këshillat e prindërve ... 15

Komisioni i shëndetit, sigurisë dhe mjedisit ... 15

Disponueshmëria e linjës së transportit të dedikuar ... 15

Shpërndarja dhe ofrimi i shërbimit të shkollave dhe konvikteve të arsimit parauniversitar ... 15

Frekuentimi në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm ... 16


REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

Arsimi Fillor ........ 16

Arsimi 9-Vjeçar ........ 16

Arsimi i Mesëm ........ 17

3. Shërbimi i Arsimit sipas njësive administrative ........ 17

Njësia Administrative: Krumë ........ 17

Njësia Administrative: Fajza ........ 18

Njësia Administrative: Gjinaj ........ 19

Njësia Administrative: Golaj ........ 19

4. Vizioni, qëllimet strategjike, objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar ........ 20

Përmbledhje e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve ........ 22

Përmbledhje e investimeve kapitale (2026–2028) ........ 23

Qëllimi dhe ndikimi i investimeve: ........ 23

5. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar ........ 24

Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar ........ 24

Buxheti i planifikuar në funksion të përmbushjes së objektivave të planit të arsimit Parauniversitar të bashkisë Has (2025–2028) ........ 24

6. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve) ........ 28

7. Plani i investimeve kapitale ........ 50

8. Monitorimi dhe vlerësimi ........ 51

9. Rishikimi dhe përshtatja e planit ........ 53

10. Raportimi dhe transparenca ........ 53

11. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar ........ 54

12. Aneks 2: Lista e kopshteve në Bashkinë Has ........ 55

13. Aneks 3: Lista e shkollave në Bashkinë Has ........ 56

## Parathënie



Arsimi është një nga shtyllat kryesore mbi të cilat ndërtohet e ardhmja e çdo komuniteti. Në Bashkinë Has, jemi të bindur se garantimi i të drejtës për arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm për çdo fëmijë është jo vetëm një detyrim institucional, por një angazhim i përditshëm për zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të territorit tonë.

Në këtë frymë, Plani i Arsimit Parauniversitar 2026–2028 është hartuar si një dokument udhëzues, i bazuar në analizën e detajuar të realitetit arsimor në Has dhe i ndërtuar në bashkëpunim të ngushtë me institucionet arsimore, stafin drejtues e edukativ, përfaqësues të komunitetit, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerë të zhvillimit.

Ky plan synon të japë zgjidhje konkrete për sfidat aktuale, duke ndërmarrë një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse për përmirësimin e infrastrukturës arsimore, modernizimin e mjediseve të të nxënit, forcimin e kapaciteteve profesionale të mësuesve dhe edukatorëve, garantimin e shërbimeve mbështetëse për fëmijët me aftësi ndryshe dhe grupet në nevojë, si dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive të komunitetit në procesin arsimor.

**Vizioni që udhëheq këtë plan është:**

***"Të ndërtojmë një sistem arsimor gjithëpërfshirës, cilësor dhe të aksesueshëm në çdo njësi administrative të Bashkisë Has, që garanton zhvillimin e plotë të çdo fëmije dhe të riu përmes kushteve të denja mësimore, mbështetjes sociale dhe angazhimit të komunitetit në procesin edukativ."***

Ky plan nuk është thjesht një listë investimesh apo aktivitetesh, por një angazhim institucional për të ecur përpara me politika arsimore që vendosin në qendër fëmijën dhe të rinjtë. Ai përcakton objektiva të matshëm, aktivitete të strukturuara dhe një kornizë të qartë financiare që siguron zbatimin e qëndrueshëm të nismave të ndërmarra.

Si Kryetar i Bashkisë Has, shpreh vullnetin dhe përkushtimin tim të plotë për zbatimin e këtij plani, si dhe për forcimin e partneritetit ndërinstitucional që mundëson ofrimin e një shërbimi arsimor të denjë për çdo qytetar të Hasit. Vetëm përmes bashkëpunimit, përkushtimit dhe vizionit të përbashkët do të arrijmë të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për fëmijët tanë dhe për brezat që vijnë.

**Kryetari i Bashkisë Has**

Miftar Dauti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

## *Falënderime*

*Bashkia Has shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit të të Arsimit Parauniversitar 2026–2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të bashkive të Shqipërisë dhe me ekspertizën teknike të "Smart Processes", të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik vendor.*

*Falënderojmë në mënyrë të veçantë angazhimin e Këshillit Bashkiak të Hasit, për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë procesit, si dhe për angazhimin e strukturave të tij në sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe transparente.*

*Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive dhe sektorëve vendorë të arsimit, financave, infrastrukturës, shërbimeve sociale, si dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, edukatorëve dhe mësuesve që ofruan informacion të vlefshëm dhe reflektim mbi nevojat reale në terren.*

*Mirënjohje shkon edhe për organizatat e shoqërisë civile, këshillat e prindërve, grupet komunitare dhe partnerët lokalë, të cilët morën pjesë në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e realitetit arsimor dhe prioriteteve të komunitetit.*

*Ky plan përfaqëson një vullnet të përbashkët për të ndërtuar një sistem arsimor më të mirë për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Has..*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

# 1. Hyrje dhe konteksti

## Konteksti administrativ

Bashkia Has ndodhet në pjesën verilindore të Shqipërisë dhe kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Kukës dhe në lindje me Republikën e Kosovës. Qendra administrative e saj është qyteti i Krumës, i shpallur qytet në vitin 1972, i cili shërben si pikë kyçe për administrimin dhe ofrimin e shërbimeve publike në territorin e kësaj bashkie.

Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 374 km², duke rezultuar në një densitet prej rreth 29,2 banorë për kilometër katror. Ky tregues nënvizon përhapjen e popullsisë në një territor të gjerë, me tipare të theksuara rurale dhe malore.

Bashkia përbëhet nga 4 njësi administrative:

- Krumë,
- Fajza,
- Gjinaj dhe
- Golaj.

Në total, Bashkia Has përfshin 1 qytet dhe 29 fshatra. Këto njësi përbëjnë boshtin organizativ të ofrimit të shërbimeve publike për komunitetin lokal, përfshirë edhe arsimin parashkollor dhe parauniversitar.

Topografia e zonës është mjaft e larmishme, duke filluar nga rreth 300 metra mbi nivelin e detit dhe duke u ngjitur deri në majat e larta malore si Gajrepi, Pashtriku dhe Maja e Kunorës (1400–1989 m mbi nivelin e detit). Kjo larmi relievi ndikon ndjeshëm në organizimin hapësinor të infrastrukturës dhe nevojën për politika të diferencuara në ofrimin e shërbimeve, veçanërisht në arsim dhe kujdes për fëmijët.

Bashkia Has mbart trashëgimi të pasur minerare dhe zejtare. Shfrytëzimi i nëntokës ka nisur që në vitet '30 nga italianët, me funksionimin e minierave të bakrit dhe fabrikës së pasurimit në Golaj. Edhe pse aktivitetet industriale janë ndërprerë në mesin e viteve '90, potenciali nëntokësor në zona si Nikoliq, Krumë, Golaj dhe Zahrisht mbetet i pashfrytëzuar plotësisht. Kjo e bën Hasin një zonë me potencial zhvillimi ekonomik në të ardhmen.

Nga ana tjetër, për shkak të vendndodhjes së saj në shtegun turistik malor Theth–Valbonë–Kukës, Hasi përbën gjithashtu një destinacion potencial për zhvillimin e turizmit rural dhe malor. Traditat e pasura etnografike, prodhimet artizanale prej leshi dhe zanatet karakteristike si bukëpjekësia, e pasurojnë më tej identitetin lokal dhe mund të kontribuojnë në zhvillimin gjithëpërfshirës të zonës.

Struktura e përbërë nga një ndërthurje e zonave urbane dhe rurale, me prani të konsiderueshme të komuniteteve të margjinalizuara dhe distanca të mëdha gjeografike, kërkon një qasje të integruar dhe të diferencuar për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të arsimit parashkollor. Për të garantuar barazi dhe cilësi të njëtrajtshme,

Bashkia Has duhet të adresojë me kujdes sfidat që lidhen me aksesin, infrastrukturën dhe shpërndarjen e burimeve në të gjithë territorin e saj.

| Të dhëna administrative | Vlerë |
|---|---|
| **Sipërfaqja** | 374 km² |
| **Popullsi bashkisë** | 11,684 (5,684 meshkuj/ 6,000 femra (Cens 2023) |
| **Njësi administrative** | Krumë, Fajza, Gjinaj dhe Golaj |
| **Fshatra të përfshira** | 29 fshatra përmes njësive |

**Të dhëna demografike**

Sipas të dhënave më të fundit demografike, numri total i banorëve në Bashkinë Has është 11,684 banorë, me një shpërndarje të përafërt gjinore prej 5,684 meshkuj dhe 6,000 femra,ndersa sipas Regjistrimit të Gjendjes Civile bashkia Has ka një popullsi prej 21.764 banorësh. Struktura e popullsisë karakterizohet nga një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve në moshë parashkollore dhe të rinjve, gjë që nënvizon rëndësinë e zhvillimit dhe forcimit të shërbimeve arsimore në këto kategori.




Kjo përbërje demografike tregon nevojën për një planifikim të kujdesshëm të burimeve arsimore, duke marrë parasysh kërkesën e lartë për shërbime edukimi, veçanërisht në fazat e hershme të zhvillimit të fëmijëve dhe në arsimin e mesëm.

**Struktura e popullsisë së re dhe implikimet për Arsimin**

Të dhënat e popullsisë për grupmoshat 0–19 vjeç në Bashkinë Has ofrojnë një panoramë të qartë mbi strukturën e brezit të ri dhe ndikimin që kjo ka në planifikimin e shërbimeve arsimore. Konkretisht:

- **Grupmosha 0–4 vjeç**: 753 fëmijë
- **Grupmosha 5–9 vjeç**: 908 fëmijë
- **Grupmosha 10–14 vjeç**: 980 fëmijë
- **Grupmosha 15–19 vjeç**: 905 të rinj

Kjo shpërndarje tregon për një strukturë të qëndrueshme demografike të fëmijëve dhe të rinjve, me një rritje të lehtë të numrit të fëmijëve në moshë shkolle bazë (5–14 vjeç), krahasuar me grupmoshën parashkollore (0–4 vjeç). Ndërkohë, grupmosha 15–19 vjeç përfaqëson adoleshentët që ndjekin arsimin e mesëm ose janë në kalim drejt arsimit të lartë apo tregut të punës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

**Implikimet kryesore për ofrimin e shërbimeve arsimore janë:**

**1. Grupmosha (0–4 vjeç):**

- Me 753 fëmijë në këtë grupmoshë, është evidente, sidomos në zonat rurale të thella ku qasja është më e kufizuar.
- Kërkohet përmirësim i infrastrukturës dhe forcimi i përfshirjes së fëmijëve të grupeve vulnerabël, duke përfshirë edhe komunitetet e margjinalizuara.

**2. Grupmosha (5–14 vjeç):**

- 1888 fëmijë (grupmoshat 5–9 dhe 10–14 vjeç) përbëjnë bërthamën e sistemit të arsimit **bazë**, çka kërkon:
  - Përmirësimin e infrastrukturës të shkollave 9-vjeçare në zona me densitet më të lartë.
  - Sigurimin e stafit arsimor të mjaftueshëm dhe të kualifikuar.
  - Organizim efektiv të transportit për nxënësit në zona të largëta malore.

**3. Grupmosha (15–19 vjeç):**

- Me 905 të rinj në këtë grupmoshë, ka nevojë për:
  - Ofrim të programeve të arsimit të mesëm të përgj//ithshëm dhe profesional, në përputhje me nevojat e tregut lokal të punës.
  - Masa mbështetëse për të nxitur vijueshmërinë shkollore dhe për të reduktuar braktisjen e hershme.

**Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor**

Zbatimi i funksioneve të Bashkisë Has në fushën e arsimit parauniversitar mbështetet në një kuadër të plotë kushtetues, ligjor dhe politik, i cili përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike në garantimin e të drejtës për arsim cilësor, të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët.

Baza më e lartë ligjore është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin 57, pika 1, sanksionon të drejtën për arsim. Kjo e drejtë merr formë praktike përmes Ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar me Ligjin nr. 48/2018, "Për sistemin arsimor parauniversitar", i cili përcakton strukturën, standardet dhe mënyrën e funksionimit të institucioneve arsimore nga arsimi parashkollor deri te ai i mesëm i përgjithshëm dhe profesional.

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i njeh bashkive kompetenca të plota për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e çerdheve dhe kopshteve publike. Ndërsa në arsimin bazë dhe të mesëm, bashkitë kanë funksione mbështetëse, kryesisht në garantimin e infrastrukturës, përfshirjes sociale dhe bashkërendimit me institucionet qendrore. Këto funksione financohen dhe mbështeten përmes Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe Ligjit nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor", të cilët përcaktojnë rregullat e menaxhimit financiar në nivel vendor. Gjithashtu, Ligji nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, mundëson mobilizimin e të ardhurave vendore për mbështetje të sektorit arsimor.

Në nivel zbatimi, funksionimi i institucioneve arsimore në territorin e Bashkisë Has mbështetet nga akte nënligjore specifike, ndër të cilat:

- Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020, për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare;
- Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023, për përcaktimin e numrit të nxënësve në klasë dhe të ngarkesës mësimore për mësuesit;
- Udhëzimi i përbashkët MAS-MEKI nr. 13, datë 10.07.2024, për organizimin e vitit shkollor 2024–2025;
- Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018, për funksionimin e bordeve të institucioneve arsimore si mekanizma bashkëpjesëmarrjeje dhe mbikëqyrjeje në nivel lokal.

Për arsimin parashkollor, një dokument me rëndësi është Urdhri nr. 199, datë 07.05.2024, i cili miraton Kornizën e vlerësimit të cilësisë së kopshteve, duke ndihmuar në monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së kujdesit dhe edukimit të hershëm.

Në përputhje me angazhimet për përfshirje dhe mbrojtjen e fëmijëve, Bashkia Has mbështetet gjithashtu në:

- Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror";
- Ligjin nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", që kërkojnë ndërhyrje të koordinuara për fëmijët në nevojë;
- Udhëzimin nr. 21, datë 08.08.2014, për rritjen e frekuentimit të arsimit nga fëmijët romë;
- Planin Kombëtar të Veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025, i cili udhëheq politikat sociale dhe arsimore në territor.

Një aspekt me rëndësi shtesë është ofrimi i shërbimeve psiko-sociale në shkolla, i cili mbështetet nga Urdhri nr. 313, datë 20.10.2020 dhe udhëzuesit për punën e psikologëve dhe punonjësve socialë në institucionet arsimore. Po ashtu, për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet e mjedisit dixhital, **zbatohet** Udhëzimi i përbashkët MAS-MShMS nr. 658, datë 23.09.2019.

Nëpërmjet këtij kuadri të strukturuar, Bashkia Has ushtron rolin e saj si një aktor kyç në ofrimin e arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën Vendore Arsimore dhe strukturat përkatëse. Kjo qasje synon të garantojë që çdo fëmijë, pa dallim vendbanimi, etnie apo statusi social, të ketë mundësi të barabarta për edukim dhe zhvillim.

## 2. Analiza e shërbimit të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2024 – 2025

### Shpërndarja dhe ofrimi i shërbimit të arsimit parashkollor

Struktura territoriale e institucioneve arsimore në Bashkinë Has dëshmon për një prani të qëndrueshme të infrastrukturës të arsimit parashkollor në të gjitha njësitë administrative.

Të dhënat tregojnë se në këtë territor funksionojnë **20 kopshte publike, pa ushqim, të** shtrira në mënyrë të balancuar si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale.

Kjo shpërndarje gjeografike reflekton angazhimin institucional për të siguruar akses të barabartë në edukimin e hershëm për të gjithë fëmijët, pavarësisht vendbanimit. Prania e këtyre institucioneve edhe në zonat më të thella të territorit shërben si tregues i politikave gjithëpërfshirëse që synojnë përfshirjen e fëmijëve në kopsht që në moshë të hershme.

-REPUBLIKA E SHQIPËRISË-
BASHKIA HAS

**Frekuentimi në Arsimin Parashkollor**

Sipas të dhënave më të fundit, në territorin e Bashkisë Has (census 2023) jetojnë 644 fëmijë të grupmoshës 3–6 vjeç, prej të cilëve 331 janë djem dhe 313 vajza. Nga ky total, 473 fëmijë janë të përfshirë aktualisht në institucionet e arsimit parashkollor, 245 djem dhe 228 vajza – duke përfaqësuar një normë përfshirjeje prej 73.44%.

Ndërkohë, 171 fëmijë të kësaj grupmoshe nuk ndjekin kopshtin, përkatësisht 86 djem **dhe** 85 vajza. Ky boshllëk në përfshirje i atribuohet kryesisht fenomeneve të migrimit të brendshëm dhe emigrimit, të cilat ndikojnë në lëvizshmërinë dhe vendbanimin real të fëmijëve.




**Është me rëndësi të theksohet** se **nuk është identifikuar asnjë fëmijë rezident në Bashkinë Has i cili, ndonëse banon në territor, të jetë përjashtuar nga ndjekja e arsimit parashkollor**.

Kjo sugjeron se shërbimi i ofruar aktualisht mbulon në masë të mirë popullsinë rezidente.

Analiza gjinore e përfshirjes tregon se:

- 51.79% e fëmijëve të përfshirë janë djem
- 48.20% janë vajza

Këto të dhëna nënvizojnë nevojën për politika të vazhdueshme për zgjerimin e aksesit, përmirësimin e infrastrukturës dhe ndërhyrje gjithëpërfshirëse, me synimin për të garantuar të drejtën e çdo fëmije për edukim të hershëm cilësor, pa dallim gjinie apo vendbanimi, në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Has.

**Tipologjia e godinave dhe kapaciteti akomodues**

- 15 kopshte funksionojnë brenda ambienteve të shkollave ose në hapësira të përbashkëta ("Godinë brenda ambjentit të shkollës/tjetër").
- 5 kopshte kanë godinë më vete, të dedikuar për aktivitetin parashkollor:
    - Brenog (Fajza)
    - Kopshti Gajrep (Krume)
    - "1 Qershori" (Krume)
    - Kopshti Zgjeç dhe Demokracia Gjinaj

Kjo ndarje tregon se pjesa më e madhe e kopshteve mbështeten në infrastrukturë të përbashkët, duke theksuar nevojën për përshtatjen e ambienteve të dedikuara për arsimin parashkollor.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

**Kapaciteti akomodues**

Kapacitetet e kopshteve variojnë nga 12 deri në 178 fëmijë. Disa prej vlerave kryesore janë:

- Kopshti me kapacitetin më të lartë është "1 Qershori" në Krume me 178 vende, një qendër urbane e rëndësishme për Bashkinë.
- Kapaciteti më i ulët është në kopshte si Dobrunë,Tregtan, Kosturr dhe Zgjeç, **12 vende**.

**Fëmijët me aftësi të kufizuara (AK)**

Në total janë identifikuar 8 fëmijë (5 vajza) me aftësi të kufizuara, prej të cilëve 5 janë vajza. Këto raste janë të përqendruara kryesisht në zona me qendra më të mëdha si Kruma dhe Golaj.

- Fëmijë me AK mendore janë raportuar në:
  - Shkolla "Sali Hajdari" – Helshan: 3 fëmijë (2 vajza)
  - Kopshti Golaj: 3 fëmijë (2 vajza)
  - "1 Qershori" – Krume: 2 fëmijë (1 vajzë)
- Fëmijë me AK fizike janë raportuar vetëm në:
  - Shkolla "Sali Hajdari" – Helshan: 1 vajzë
  - "1 Qershori" – Krume: 1 djalë

Zbatimi i PEI është ende shumë i kufizuar dhe përqendrohet vetëm në dy institucione, duke treguar nevojën për zgjerim të mbështetjes arsimore të individualizuar për fëmijët me AK.

**Fëmijë me program mbrojtjeje individuale**

- Në asnjë prej kopshteve nuk është raportuar ndonjë fëmijë me program mbrojtjeje individuale (psh. për raste abuzimi, braktisjeje apo vulnerabiliteti të theksuar).

**Fëmijë nga komuniteti rom dhe egjiptian**

Nuk ka.

**Fëmijë që vijnë nga familje me ndihmë ekonomike**

- Institucionet me përqindjen më të lartë të fëmijëve me ndihmë ekonomike:
  - "1 Qershori" – Krumë: 90 fëmijë (50 vajza)
  - Kopshti Golaj: 26 (10 vajza)
  - Kopshti Fajza: 16 ( 6 vajza)
  - Shkolla Helshan: 19 ( 8 vajza)
  - Metaliaj: 19 ( 9 vajza)
  - Vlahen: 15 ( 5 vajza)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Ka një numër të konsiderueshëm fëmijësh që vijnë nga familje me ndihmë ekonomike, veçanërisht në qendrat me popullsi më të dendur. Kjo sugjeron nevojën për masa mbështetëse sociale për të garantuar frekuentim të rregullt dhe pjesëmarrje cilësore në edukim.

**Fëmijë me status social tjetër (psh. jetim, me prindër emigrantë, etj.)**

- Kopshti Golaj: 6 fëmijë (2 vajza)
- Demokracia Gjinaj: 6 fëmijë (6 vajza)

- Perollaj: 8 fëmijë (4 vajza)
- Zgjeç: 3 fëmijë (2 vajza)

Edhe pse numri është më i ulët, është e rëndësishme të theksohet përqindja relativisht e lartë e vajzave në këtë kategori, që kërkon ndërhyrje të ndjeshme gjinore në mbështetje.

**Burimet njerëzore në ofrimin e shërbimit të arsimit parashkollor**

**Numri total i mësueseve**

Numri total i mësuesve që shërbejnë në arsimin parashkollor është 35.

- Kopshti me numrin më të lartë të stafit është "1 Qershori",Krume me 11 mësuese.
- Kopshte me vetëm 1 mësuese: Letaj, Metaliaj, Kosturr, Perollaj, Kopshti Fajza, Demokracia Domaj etj.
- Kopshtet me 3 mësuese janë më të rralla dhe zakonisht në zona me frekuentim më të lartë (p.sh. Kopshti Golaj).

**Kualifikimi arsimor i edukatoreve të arsimit parashkollor.**

- Mësuese me arsim të lartë janë të pranishme në shumicën e kopshteve, duke përfshirë:
    - "1 Qershori" Krume: 11 mësuese
    - Në **Zgjeç,Letaj,Perollaj,Dobrunë,Nikoliç,Fajza,Vranisht,Metaliaj,"Sejdi Dida",Zahrisht: 1 edukatore secili.**
    - **Shkolla "Sali Hajdari" Helshan,Shkolla"Arif Zeqir Brati"Golaj,Shkolla" Rexhep Hoxha"Tregtan,Gjinaj:** 2 edukatore secili

- Arsimi i mesëm pedagogjik është raportuar si formimi kryesor në disa kopshte

Nivelet e kualifikimit janë më të ulëta në zonat periferike , ndërsa qendrat urbane si Kruma kanë staf më të kualifikuar.

**Mësueset ndihmëse**

- Vetëm Kopshti Golaj dhe"1 Qershori" kanë të punësuar mësuese ndihmëse (1 dhe 2 përkatësisht).

Kjo tregon nevojën për shtimin e stafit mbështetës progresivisht, veçanërisht në kopshte me përfshirje të lartë të fëmijëve me nevoja të veçanta ose nga grupe vulnerabël sipas vlerësimit të komisionit përkatës..

**Eksperienca e mësueseve**

- Mësuese me mbi 25 vjet eksperiencë janë të pranishme në:
    - "1 Qershori" ( 5 mësuese)
    - "Sejdi Dida" ( 1 mësuese)
    - Gajrep ( 1 mësuese)
    - Tregtan ( 1 mësuese)
    - Nikoliq ( 1 mësuese)
    - Dobrunë ( 1 mësuese)

-REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA HAS

- Letaj ( 1 mësuese)
- Vlahen ( 1 mësuese)

- Mësuese me eksperiencë 11-24 vjet janë raportuar në disa raste.
  - "1 Qershori" ( 2 mësuese)
  - Fajza ( 1 mësuese)
  - Kosturr ( 1 mësuese)
  - Golaj ( 2 mësuese)
  - Brenog ( 1 mësuese)
  - Gjinaj ( 1 mësuese)
  - Helshan ( 1 mësuese)
- Pjesa tjetër e mësueseve janë me eksperience pune 1-10 vjet , gjë që tregon se një pjesë e madhe e stafit është në mes të karrierës.

**Infrastruktura e godinës së kopshtit dhe aksesueshmëria**

**Aksesueshmëria – Rampat në kopshte**

Nga totali i **20 kopshteve** të listuara:

- **16 kopshte** raportojnë se janë në nivel me tokën dhe nuk kanë nevojë për rampa. Kjo tregon aksesueshmëri të mirë fizike për fëmijët.
- **4 kopshte** :" Sejdi Dida"Krumë, **Nikoliq**, **Demokracia Gjinaj**, **Demokracia Domaj**) **kanë rampa**.

**Nevoja për rikonstruksion**

Nga 20 kopshte:

- **18** kanë **nevojë për përmirësime**
- **2** janë **në gjendje të mirë dhe nuk kërkojnë ndërhyrje**: Letaj, , Demokracia Gjinaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA HAS

**Llojet e ndërhyrjeve dhe prioritarizimi i ndërhyrjeve:**

Lista e kopshteve me prioritet të lartë për ndërhyrje (rikonstruksion total)

| Emri i Kopshtit | Shfrytëzimi i kapacitetit (%) | Koment |
|---|---|---|
| **Kopshti "1 Qershori", Krumë** | 110% | Prioriteti më i lartë – shumë fëmijë, kërkon rikonstruksion të ambjenteve të brendshme |
| **Kopshti Tregtan** | 100% | Prioriteti më i lartë – shumë fëmijë, kërkon zgjerim/ndërtim të ambjenteve të brendshme |
| **Kopshti Golaj** | 74.29% | Prioriteti më i lartë – shumë fëmijë, kërkon rikonstruksion total |
| **Kopshti Fajza** | 80.00% | Ngarkesë e lartë dhe kërkesë për rikonstruksion të plotë |
| **Kopshti Liman** | 52.94% | Mbushje mesatare, ndërhyrje e plotë |

| | | |
|---|---|---|
| **Mazrreku** | | |
| **Kopshti Gajrep** | 71.43% | Edhe ky ka shfrytezim të lartë dhe kërkon rikonstruksion |
| **Zgjeç** | 33.33% | Shfrytezim i ulët por kërkon rikonstruksion të plotë |

Prioritet i mesëm – Rikonstruksion i brendshëm/jashtëm

| Emri i Kopshtit | Shfrytëzimi i kapacitetit (%) | Koment |
|---|---|---|
| **Nikoliq** | 71.43% | Rikonstruksion i brendshëm, kopësht me shfrytëzim të lartë |
| **Vlahen** | 83.33% | Shfrytëzim i kapavitetit, kërkon ndërhyrje të brendshme |
| **Kosturr** | 33.33% | Rikonstruksion i jashtëm, por me shfrytëzim të kapacitetit të ulët |

Prioritet më i ulët – Lyerje

| Emri i Kopshtit | Shfrytëzimi i kapacitetit (%) |
|---|---|
| **Brenogë** | 60.91% |
| **Shkolla "Sali Hajdari"** | 100% |
| **Perollaj** | 38.89% |
| **Zahrisht** | 52.94% |
| **Demokracia Domaj** | 62.50% |
| **Dobrune** | 16.67% |

**Vetëm mobilieri**

- **Kopshti Metaliaj** – 90.48% shfrytëzim kapaciteti, kërkon mobilim, prioritet i mesëm për përmirësim.

**Pa nevojë për rikonstruksion (Gjendje e mirë)**

- Letaj
- Demokracia Gjinaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

**Strukturat pjesëmarrëse dhe mbikëqyrëse në kopshte**

Të dhënat e mbledhura nga institucionet parashkollore të Bashkisë Has tregojnë një përfshirje të përgjithshme të strukturave vendimmarrëse dhe këshillimore në funksion të mirëmenaxhimit dhe bashkëpunimit me komunitetin. Konkretisht, pjesa më e madhe e kopshteve kanë ngritur bordin e

kopshtit, këshillin e prindërve, komisionin e shëndetit, sigurisë dhe mjedisit, megjithatë vërehen disa boshllëqe dhe nivele të ndryshme funksionaliteti.

**Bordi i kopshtit** është themeluar në 16 prej 20 kopshteve të përfshira në raportim. Në disa prej tyre, si Nikoliq, Brenog dhe Perollaj, bordi mungon ende. Numri i anëtarëve të bordit varion ndjeshëm, nga 2 anëtar në Letaj, deri në 7 anëtarë në Kopshtin Golaj . Shumica e bordeve përfshijnë edhe anëtare të gjinisë femër, megjithatë ka raste si Kosturri dhe Zgjeçi ku nuk është raportuar pjesëmarrje e grave në bord. Aktiviteti i bordeve ndryshon gjithashtu: në disa kopshte janë mbajtur vetëm 2–3 mbledhje në vit, ndërsa në raste të veçanta si "Demokracia" Gjinaj janë mbajtur deri në 6 mbledhje, duke treguar një angazhim më të lartë në qeverisjen institucionale.

**Këshillat e prindërve** janë të pranishëm në të gjitha institucionet, me përjashtim të ndonjë kopshti me të dhëna të paplota. Struktura e këshillave ndryshon sipas madhësisë së institucionit: Për shembull, në Metaliaj ka 9 anëtarë, ndërsa në disa kopshte rurale si Perollaj dhe Kosturr ka vetëm 2–3. Edhe këtu vërehet pjesëmarrje e konsiderueshme e nënave. Aktiviteti i këshillave është përgjithësisht i mirë, me numër mbledhjesh që varion nga 2 deri në 9 gjatë vitit, ku Dobrune dhe "Demokracia" Domaj shfaqen ndër më aktivët.

**Komisioni i shëndetit, sigurisë dhe mjedisit** është krijuar në 14 prej kopshteve të përfshira. Në pesë të tjera – përkatësisht Nikoliq, Brenog, Perollaj, Gajrep dhe Zahrisht – nuk rezulton të jetë ngritur një komision i tillë. Aty ku komisionet ekzistojnë, përbërja është e ndryshme: nga 1 deri në 7 anëtarë. Në shumicën e tyre është përfshirë edhe të paktën një anëtare grua, megjithatë pjesëmarrja gjinore nuk është gjithmonë e barabartë. Numri i mbledhjeve vjetore të zhvilluara nga komisionet ndryshon ndjeshëm: nga vetëm 1 mbledhje në disa kopshte si "1 Qershori"

**Disponueshmëria e linjës së transportit të dedikuar**

Nga 20 kopshte të përfshira në raportim:

- 10 kopshte kanë linjë transporti të dedikuar ose të kontraktuar për fëmijët dhe/ose mësuesit.
    - Këto përfshijnë: Letaj, Metaliaj, Tregtan, Shkolla "Sali Hajdari" Helshan, Kopshti Golaj, Perollaj, "1-Qershori", Kopshti Fajza, Vlahen dhe Sejdi Dida.

**Shpërndarja dhe ofrimi i shërbimit të shkollave dhe konvikteve të arsimit parauniversitar**

Në tërësi, rrjeti arsimor në Bashkinë Has përbëhet nga 19 institucione arsimore të niveleve të ndryshme, të cilat mbulojnë në mënyrë të plotë të gjitha njësitë administrative. Ky rrjet ofron një bazë të rëndësishme për garantimin e edukimit cilësor dhe të qasshëm në të gjithë territorin dhe përbën një aset kyç në zhvillimin arsimor të fëmijëve dhe të rinjve në këtë bashki.




Rrjeti i institucioneve arsimore në territorin e Bashkisë Has është organizuar në mënyrë të tillë që të sigurojë mbulim sa më të plotë të nevojave edukative të komunitetit, me fokus në afërsinë me vendbanimet dhe barazinë në akses.

Shkollat klasifikohen sipas cikleve të edukimit dhe përfshijnë:

- **Shkolla fillore – 2 në total**

  Këto institucione ofrojnë edukimin bazë në klasat e para dhe janë të vendosura afër zonave të banuara për të mundësuar akses të lehtë për fëmijët më të vegjël. Ato luajnë rol themelor në sigurimin e aftësive bazë si leximi, shkrimi dhe matematika.

- **Shkolla 9-vjeçare – 15 në total**

  Të strukturuara për të përfshirë ciklin fillor dhe atë të mesëm të ulët, këto shkolla përbëjnë bërthamën e sistemit të arsimit bazë. Ato ndihmojnë në formimin akademik dhe zhvillimin social të fëmijëve, si dhe në përgatitjen e tyre për kalimin në arsimin e mesëm.

- **Shkolla të mesme – 2 në total**

  Përfshirë kryesisht gjimnaze, këto institucione ndodhen në zona të përzgjedhura strategjikisht, për të përfshirë sa më shumë nxënës nga gjithë territori i bashkisë. Ato kanë për qëllim përgatitjen e të rinjve për studime të mëtejshme universitare dhe pjesëmarrje aktive në shoqëri.

**Shërbimi i konvikteve**

Për të mbështetur nxënësit që vijnë nga zona të largëta apo që kanë vështirësi ekonomike, në territorin e Bashkisë Has funksionon konvikti "Kosova", **i** cili në vitin shkollor 2024–2025 strehon gjithsej 22 nxënës (prej të cilëve 17 janë vajza dhe 5 djem**)**. Të gjithë këta nxënës trajtohen me bursë të plotë 100%, duke garantuar kushte dinjitoze jetese dhe arsimimi.

**Frekuentimi në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm**

**Arsimi Fillor**

Në ciklin fillor janë të regjistruar gjithsej 17 nxënës, prej të cilëve 10 janë djem dhe 7 vajza. Këta nxënës ndjekin shkollën në fshatrat Kosturr dhe Dobrunë, që i përkasin Njësisë Administrative Golaj. Ky numër i kufizuar pasqyron dinamikat demografike lokale, si dhe ndikimin e faktorëve të tjerë si migrimi, largësia nga shkolla apo mungesa e burimeve.

Kjo situatë nënvizon nevojën për masa të vazhdueshme për të garantuar akses të barabartë në arsim për të gjithë fëmijët, pavarësisht vendbanimit apo kushteve socio-ekonomike. Sigurimi i transportit, përmirësimi i infrastrukturës dhe mbështetja sociale janë faktorë kyç për rritjen e përfshirjes në këtë cikël.

**Arsimi 9-Vjeçar**

Në ciklin 9-vjeçar janë të regjistruar gjithsej 1,662 nxënës, nga të cilët 893 janë djem dhe 769 janë vajza, duke përfaqësuar respektivisht 53.73% dhe 46.26% të popullsisë shkollore në këtë nivel. Shpërndarja gjinore është relativisht e balancuar, por vërehen diferenca mes njësive administrative, të cilat lidhen me faktorë lokalë si largësia nga shkollat, mundësitë familjare dhe sensibilizimi komunitar për rëndësinë e arsimit.

Pavarësisht pjesëmarrjes së lartë në këtë nivel, nevojitet një monitorim i vazhdueshëm për të ndjekur vijueshmërinë shkollore dhe për të parandaluar braktisjen, sidomos në moshat e ciklit të dytë të arsimit bazë. Mbështetja me materiale mësimore, shërbimet psiko-sociale dhe angazhimi i komunitetit janë mekanizma të domosdoshëm për të rritur cilësinë dhe vazhdimësinë e shkollimit.

**Arsimi i Mesëm**

Në arsimin e mesëm, nga të dhënat e Censit (2023) ndjekin mësimin gjithsej 420 nxënës, ku 176 janë djem (41.90%) dhe 244 janë vajza (58.09%). Ky raport pasqyron një pjesëmarrje më të lartë të vajzave, e cila mund të interpretohet si rezultat i faktorëve të ndryshëm si afërsia e shkollës, motivimi familjar apo mbështetja institucionale.Aktualisht ndjekin mësimin 394 nxënës ndjekin mësimin,ku 159 janë djem ( 40,35% ) dhe 235 janë vajza (59,64%).

Përveç kësaj, 39 nxënës nga Bashkia Has ndjekin arsimin profesional jashtë territorit të Bashkisë Has, gjë që tregon interesin në rritje të të rinjve për profile praktike që lidhen me tregun e punës.

Investimet në infrastrukturë, burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse do të jenë vendimtare për të përmirësuar cilësinë, gjithëpërfshirjen dhe vijueshmërinë në të gjitha nivelet arsimore.

## 3. Shërbimi i Arsimit sipas njësive administrative

**Njësia Administrative: Krumë**

Në Njësinë Administrative të Krumës funksionojnë gjithsej 4 shkolla, të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Prej tyre, 3 janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit parauniversitar dhe 1 është shkollë e mesme. Nuk ka shkolla vetëm për ciklin fillor. Përmes këtij rrjeti, njësia siguron një shtrirje të qëndrueshme të shërbimeve arsimore, duke garantuar mundësi të barabarta për ndjekjen e arsimit bazë dhe përgatitjen për arsimin e lartë apo tregun e punës.

Institucionet janë të pozicionuara në mënyrë të tillë që të sigurojnë akses si për fëmijët që jetojnë në zonën urbane të Krumës, ashtu edhe për ata në zonat përreth. Kjo ndihmon në përfshirjen e fëmijëve në arsimin e detyrueshëm dhe në uljen e barrierave territoriale.

**Lista e shkollave:**

| Emri i shkollës | Nxënës gjithsej<br>Viti akademik 2024 - 2025 | Vajza | Djem |
|---|---|---|---|
| **"Adem Pista" Zahrisht** | 27 | 12 | 15 |
| **"Alush Xhebexhia" Kishaj** | 12 | 5 | 7 |
| **Pashtrik** | Mbyllur që nga viti 2022 | | |
| **Shkolla 9-vjeçare "Sejdi Dida"Krumë** | 775 | 347 | 428 |
| **Gjimnazi "Skënderbeu"Krumë** | 361 | 220 | 141 |

Në aspektin e edukimit parashkollor, kjo njësi ofron shërbime nëpërmjet një rrjeti prej 4 kopshte, të vendosura në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet. Këto kopshte mbështesin zhvillimin e hershëm të fëmijëve, përgatitjen për shkollë si dhe ndihmojnë familjet në nevojë për kujdes të strukturuar.

**Lista e kopshteve:**

| Emri i kopshtit | Fëmijë gjithsej | Vajza | Djem |
|---|---|---|---|
| | Viti akademik 2024 - 2025 | | |
| **Gajrep** | 10 | 5 | 5 |
| **"1-Qershori" Krumë** | 180 | 75 | 102 |
| **Zahrisht "Adem Piata"** | 12 | 10 | 2 |
| **"Sejdi Dida" Krumë** | 27 | 9 | 18 |

**Njësia Administrative: Fajza**

Në këtë njësi funksionojnë 4 shkolla 9-vjeçare, të cilat mbulojnë ciklin bazë të arsimit. Aktualisht, nuk ka shkolla të mesme apo shkolla vetëm për ciklin fillor. Shkollat janë të shpërndara në mënyrë gjeografike të përshtatshme për të përfshirë fëmijët e të gjitha vendbanimeve të njësisë.

**Lista e shkollave:**

| Emri i shkollës | Nxënës gjithsej | Vajza | Djem |
|---|---|---|---|
| | Viti akademik 2024 - 2025 | | |
| **"Qamil Metalia"Metaliaj** | 57 | 26 | 31 |
| **"Rexhep Hoxha" Tregtan** | 105 | 57 | 48 |
| **"Liman Mazrreku" Vranisht** | 83 | 45 | 38 |
| **"Islam Goçi" Fajza** | 60 | 26 | 34 |

Në territorin e kësaj njësie janë të hapura 5 kopshte, të cilat ofrojnë edukim parashkollor për fëmijët e moshës 3–6 vjeç. Ato janë të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar qasje të barabartë në shërbim, veçanërisht për familjet në zonat më periferike.

**Lista e kopshteve:**

| Emri i kopshtit | Fëmijë gjithsej | Vajza | Djem |
|---|---|---|---|
| | Viti akademik 2024 - 2025 | | |
| Metaliaj | 23 | 14 | 9 |
| Tregtan | 18 | 8 | 10 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| "Liman Mazrreku" | 18 | 12 | 6 |
| Brenog | 6 | 2 | 4 |
| Fajza | 20 | 10 | 10 |

**Njësia Administrative: Gjinaj**

Në Gjinaj funksionon vetëm 1 shkollë 9-vjeçare, e cila mbulon ciklin bazë të arsimit. Mungesa e shkollave të mesme dhe fillore në këtë njësi e bën të rëndësishëm funksionimin efektiv të kësaj shkolle për të gjithë fëmijët e zonës.

**Lista e shkollave:**

| Emri i shkollës | Nxënës gjithsej | Vajza | Djem |
|---|---|---|---|
| | **Viti akademik 2024 - 2025** | | |
| **Shkolla 9-vjeçare "Sinan Gjini"** | 48 | 22 | 26 |

Përsa i përket arsimit parashkollor, në këtë njësi funksionojnë 2 kopshte, të cilat mbulojnë pjesërisht nevojat e komunitetit. Këto institucione ndihmojnë në përgatitjen e fëmijëve për shkollë dhe në zhvillimin e tyre personal dhe social.

**Lista e kopshteve:**

| Emri i kopshtit | Fëmijë gjithsej | Vajza | Djem |
|---|---|---|---|
| | **Viti akademik 2024 - 2025** | | |
| **"Demokracia" Gjinaj** | 14 | 9 | 5 |
| **"Demokracia", Domaj** | 8 | 6 | 2 |

**Njësia Administrative: Golaj**

Golaj është njësia me numrin më të madh të institucioneve arsimore. Në total funksionojnë 10 shkolla, nga të cilat 2 janë shkolla fillore, 6 janë shkolla 9-vjeçare dhe 1 është gjimnaz. Kjo strukturë ofron një mbulim të plotë të cikleve të arsimit parauniversitar.

**Lista e shkollave:**

| Emri i shkollës | Gjithsej | Vajza | Djem |
|---|---|---|---|
| **Shkolla fillore Dobrunë** | - | | 3 |
| **Shkolla fillore Kosturr** | 14 | 7 | 7 |
| **Shkolla 9-vjeçare Perollaj** | 41 | 25 | 16 |
| **Shkolla 9-vjeçare Zgjeç** | 16 | 5 | 11 |
| **Shkolla 9-vjeçare "Sali Hajdari" Helshan** | 91 | 41 | 50 |
| **Shkolla 9-vjeçare Letaj** | 82 | 39 | 43 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Shkolla 9-vjeçare "Rexh Bajraktari" Vlahen** | 85 | 36 | 49 |
| **Shkolla 9-vjeçare "Jakup Jstrefi" Nikoliq** | 65 | 28 | 37 |
| **Shkolla 9-vjeçare "Arif Zeqir Brati" Golaj** | 117 | 74 | 43 |
| **Gjimnazi "Arif Zeqir Brati" Golaj** | 33 | 15 | 18 |

Në territorin e Golajt funksionojnë gjithsej **10 kopshte**, të shpërndara në qendrat e banuara dhe në fshatra të ndryshëm. Ky rrjet mbulon pjesën më të madhe të fëmijëve të moshës 3–6 vjeç, duke u shërbyer si urë kalimi drejt shkollimit të detyrueshëm.

**Lista e kopshteve:**

| Emri i kopshtit | Gjithsej | Vajza | Djem |
|---|---|---|---|
| **Letaj** | 16 | 5 | 11 |
| **Dobrune** | 6 | 2 | 4 |
| **"Sali Hajdari" Helshan** | 21 | 9 | 12 |
| **"Jakup Istrefi" Nikoliq** | 17 | 13 | 4 |
| **Kopshti "Arif Zeqiri" Golaj** | 35 | 17 | 18 |
| **Zgjeç** | 6 | 4 | 2 |
| **Kosturr** | 7 | 3 | 4 |
| **Perollaj** | 10 | 2 | 8 |
| **"Muharrem Bajraktari" Vlahen** | 19 | 8 | 11 |
| **"Arif Zeqir Brati"Golaj** | 35 | 17 | 18 |

## 4. Vizioni, qëllimet strategjike, objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar



**Vizioni**

***"Të ndërtojmë një sistem arsimor gjithëpërfshirës, cilësor dhe të aksesueshëm në çdo njësi administrative të Bashkisë Has, që garanton zhvillimin e plotë të çdo fëmije dhe të riu përmes kushteve të denja mësimore, mbështetjes sociale dhe angazhimit të komunitetit në procesin edukativ."***

Ky vizion përfaqëson një angazhim strategjik për:

- Barazi në akses (duke mbuluar të gjitha njësitë);
- Cilësi në mësimdhënie dhe zhvillim profesional të stafit;
- Mjedise të sigurta dhe të përshtatshme për mësim;
- Përfshirje sociale dhe mbështetje për fëmijët vulnerabël;
- Partneritete komunitare për edukim të gjithanshëm.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA HAS

•

**Përmbledhje e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve**

**Qëllimi 1: Rritja e aksesit dhe cilësisë së infrastrukturës arsimore, garantimi i kushteve themelore në institucionet parauniversitare dhe forcimi i kapaciteteve menaxheriale.**

**Objektivat:**

- **1.1**: Deri në fund të vitit 2028, të sigurohet funksionimi i qëndrueshëm dhe cilësor i të gjitha kopshteve dhe shkollave në territorin e Bashkisë, përmes: (i) angazhimit dhe mbështetjes së vazhdueshme të personelit edukativ dhe mbështetës; dhe (ii) garantimit të ofrimit të shërbimeve bazë (ujë të pijshëm, energji elektrike, sistem ngrohjeje, higjienë, ushqim, transport, pajisje didaktike dhe mirëmbajtje infrastrukture), në të gjitha njësitë administrative.

- **1.2**: Deri në fund të vitit 2028, të realizohen ndërhyrje rikonstruksioni në të paktën 3 institucione arsimore (kopshte dhe shkolla), përfshirë përmirësime strukturore, teknike dhe estetike, si dhe pajisjen e tyre me inventar funksional dhe mjete didaktike, me qëllim përmirësimin e kushteve mësimore dhe përputhshmërinë me standardet kombëtare të cilësisë.

- **1.3**: Deri në fund të vitit 2028, të zhvillohet dhe vihet në funksion një regjistër elektronik i menaxhimit të informacionit arsimor për të gjitha institucionet arsimore të Bashkisë, duke trajnuar të paktën 90% të stafit administrativ dhe drejtues për përdorimin e tij, dhe duke siguruar raportim të rregullt vjetor mbi performancën e sistemit arsimor në nivel njësish administrative.

**Qëllimi 2: Rritja e cilësisë së edukimit dhe garantimi i përfshirjes së barabartë të fëmijëve në sistemin parauniversitar.**

**Objektivat:**

- **2.1**: Deri në fund të vitit 2028, të sigurohet zhvillimi profesional i të paktën 90% të edukatorëve dhe mësuesve të ciklit parashkollor në Bashki, përmes realizimit të cikleve trajnimi mbi qasjet bashkëkohore pedagogjike dhe përdorimin e materialeve didaktike të unifikuara, me synim përmirësimin e praktikave mësimore dhe cilësisë së mësimdhënies

- **2.2**: Deri në fund të vitit 2028, Bashkia Has do të sigurojë angazhimin e mësuesve ndihmës dhe shërbimit psiko-social në të gjitha kopshtet publike, duke garantuar: (i) një mësues ndihmës për çdo 2-3 fëmijë me aftësi të kufizuara; (ii) praninë e psikologut ose punonjësit social në secilin institucion; dhe (iii) ofrimin e mbështetjes së strukturuar për 100% të rasteve të referuara të fëmijëve nga grupet vulnerabël, nëpërmes angazhimit të stafit të kualifikuar dhe bashkëpunimit me strukturat vendore e partnere.

- **2.3**: Të sigurohet deri në fund të vitit 2028 funksionalizimi i strukturave përfaqësuese në të gjitha institucionet arsimore parauniversitare të bashkisë, përmes krijimit, trajnimit dhe aktivizimit të bordeve, këshillave të prindërve dhe komisioneve të shëndetit e sigurisë, duke rritur bashkëpunimin efektiv ndërmjet shkollës/kopshtit, familjes dhe komunitetit lokal në të paktën 90% të shkollave dhe kopshteve.

**Qëllimi 3: Fuqizimi dhe zhvillimi gjithëpërfshirës i fëmijëve përmes nxitjes së aftësive krijuese, sociale dhe sipërmarrëse, nëpërmjet programeve jashtëkurrikulare edukative, kulturore, sportive dhe teknologjike, në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Fëmijëve dhe komunitetin.**

**Objektivat:**

- **3.1**: Të rritet me të paktën 30% deri në vitin 2028 pjesëmarrja e fëmijëve dhe të rinjve në institucionet arsimore të Bashkisë Has në aktivitete jashtëkurrikulare, kulturore, sportive, artistike dhe sociale, përmes organizimit vjetor të të paktën 10 aktiviteteve për çdo institucion arsimor, duke përfshirë të paktën 70% të fëmijëve të regjistruar, përfshirë vajza dhe fëmijë nga grupe vulnerabël.

- **3.2**: Të vendosen deri në fund të vitit 2028 të paktën 10 partneritete funksionale me institucione kulturore, organizata të shoqërisë civile dhe aktorë komunitarë, me qëllim organizimin çdo vit të të paktën 15 aktivitete edukative, kulturore dhe sociale në institucionet arsimore të Bashkisë Has, duke siguruar pjesëmarrjen e të paktën 70% të fëmijëve të regjistruar në shkolla e kopshte.

**Përmbledhje e investimeve kapitale (2026–2028)**

Plani i arsimit parauniversitar parashikon një sërë investimesh kapitale të orientuara drejt rikonstruksionit dhe përmirësimit të kushteve infrastrukturore në institucionet arsimore. Qëllimi kryesor i këtyre ndërhyrjeve është garantimi i një mjedisi mësimor bashkëkohor, të sigurt dhe gjithëpërfshirës për të gjithë nxënësit, në përputhje me standardet e edukimit cilësor.

Investimet përfshijnë rikonstruksione të plota të objekteve shkollore ekzistuese, si dhe shërbime teknike të lidhura, si supervizimi dhe kolaudimi i punimeve.

**Projektet kryesore të planifikuara:**

- Rikonstruksioni i Gjimnazit "Skënderbeu" Keumë
- Rikonstruksioni i Shkollës 9-vjeçare "Sejdi Dida"Krumë
- Rikonstruksioni i Kopshtit "1-Qershori" Krumë
- Ndertim nje ambjenti për kopësht (zgjerim i hapesires) në Shkollen" Rexhep Hoxha"Tegtan.
- Ndërtimi i një kopështi në fshatin Liqeni-Kuq Fajza, me kërkes të kryesisë së fshatit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

**Qëllimi dhe ndikimi i investimeve:**

Këto ndërhyrje synojnë jo vetëm përmirësimin fizik të godinave arsimore, por edhe krijimin e një mjedisi që nxit të nxënit, përfshirjen sociale dhe barazinë në akses për të gjithë fëmijët. Shkollat që përfitojnë nga këto projekte ndodhen në zona me rëndësi të veçantë strategjike për mbulimin e territorit dhe të popullsisë shkollore. Po ashtu, përfshirja e zërave për supervizim dhe kolaudim siguron monitorim teknik të vazhdueshëm dhe cilësi në zbatimin e projekteve.

Investimet e planifikuara kontribuojnë drejtpërdrejt në forcimin e rrjetit arsimor lokal dhe në rritjen e besimit të komunitetit ndaj sistemit publik të edukimit.

## 5. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar

### Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar

### Të dhënat financiare për shërbimin e arsimit parauniversitar

Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifat vendore. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

- Arsimi parashkollor: përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimin e infrastrukturës së kopshteve në funksion të mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve, si dhe mbështetjen për përfshirje të fëmijëve nga grupe vulnerabël.
- Arsimi 9-vjeçar dhe Arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave dhe konviktit;

### Buxheti i planifikuar në funksion të përmbushjes së objektivave të planit të arsimit Parauniversitar të bashkisë Has (2025–2028)

Përmbushja e objektivave të Planit të Arsimit Parauniversitar të Bashkisë Has mbështetet drejtpërdrejt nga një planifikim i kujdesshëm financiar, që siguron mbulim të qëndrueshëm të shpenzimeve të përhershme dhe realizimin e investimeve prioritare në infrastrukturën arsimore. Buxheti i planifikuar për periudhën 2026–2028 është ndërtuar në përputhje me tre shtylla të rëndësishme të planit: akses i barabartë, cilësi e përmirësuar e shërbimit, dhe infrastrukturë funksionale në çdo njësi administrative.

### 1. Arsimi Bazë përfshirë arsimin parashkollor

Në funksion të zgjerimit të aksesit dhe përmirësimit të kushteve të mësimdhënies, buxheti për arsimin bazë dhe atë parashkollor është projektuar të ruajë qëndrueshmëri dhe të garantojë ndërhyrje të synuara infrastrukturore:

Buxheti i përgjithshëm i planifikuar për këtë sektor për periudhën 2026–2028 arrin në 192,724 mijë **lekë**, i ndarë sipas viteve dhe kategorive të shpenzimeve si më poshtë:

**Viti 2025**
Totali i planifikuar për vitin 2025 është **67,715 mijë lekë**, i ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

- **Shpenzime personeli** (paga dhe sigurime shoqërore): 51,328 mijë lekë
- **Shpenzime korrente**: 9,844 mijë lekë
- **Shpenzime kapitale**: 6,543 mijë lekë

**Viti 2026**
Për vitin 2026, totali i planifikuar arrin në **65,119 mijë lekë**, të ndara si më poshtë:

- **Shpenzime personeli**: 48,524 mijë lekë
- **Shpenzime korrente**: 8,456 mijë lekë
- **Shpenzime kapitale**: 8,139 mijë lekë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

**Viti 2027**
Buxheti i parashikuar për vitin 2027 është **68,499 mijë lekë**, i strukturuar si më poshtë:

- **Shpenzime personeli**: 50,716 mijë lekë
- **Shpenzime korrente**: 7,783 mijë lekë
- **Shpenzime kapitale**: 10,000 mijë lekë

**Viti 2028**
Për vitin 2028, totali i planifikuar është **59,106 mijë lekë**, i ndarë në këto kategori:

- **Shpenzime personeli**: 51,210 mijë ekë
- **Shpenzime korrente**: 7,896 mijë lekë

Ky parashikim buxhetor synon të mbështesë konsolidimin e një sistemi parashkollor gjithëpërfshirës, të aksesueshëm dhe të përqendruar në cilësi, duke siguruar mbulim të qëndrueshëm me staf të kualifikuar, mirëmbajtje funksionale të institucioneve, si dhe investime për përmirësimin e infrastrukturës në vitet në vijim.

**2. Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm**

Buxheti për arsimin e mesëm gjithashtu përputhet me objektivin e rritjes së cilësisë së shërbimit dhe përfshirjes në këtë nivel: Buxheti i përgjithshëm i planifikuar për këtë sektor për periudhën 2026 – 2028 arrin në 69,447 mijë lekë, i ndarë sipas viteve dhe kategorive të shpenzimeve si më poshtë:

**Viti 2025**
Totali i planifikuar: **34,188 mijë lekë**

- **Shpenzime personeli** (paga dhe sigurime shoqërore): 12,696 mijë lekë
- **Shpenzime korrente**: 6,235 mijë lekë
- **Shpenzime kapitale**: 15,257 mijë lekë

**Viti 2026**
Totali i planifikuar: **24,259 mijë lekë**

- **Shpenzime personeli**: 15,635 mijë lekë
- **Shpenzime korrente**: 6,970 mijë lekë
- **Shpenzime kapitale**: 1,654 mijë lekë

**Viti 2027**
Totali i planifikuar: **22,350 mijë lekë**

- **Shpenzime personeli**: 13,855 mijë lekë
- **Shpenzime korrente**: 6,742 mijë lekë
- **Shpenzime kapitale**: 1,753 mijë lekë

**Viti 2028**

Totali i planifikuar: **22,838 mijë lekë**

- **Shpenzime personeli**: 14,000 mijë lekë
- **Shpenzime korrente**: 6,852 mijë lekë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

- **Shpenzime kapitale**: 1,986 mijë lekë

**Totali i Buxhetit për Arsimin parauniversitar në përputhje me objektivat strategjikë**

| Viti | Buxheti për Arsimin Bazë & Parashkollor në mijë lekë | Buxheti për Arsimin e Mesëm në lekë | Shuma vjetore e buxhetit për arsimin parauniversitar në lekë |
|---|---|---|---|
| 2025 | 67,715 | 34,188 | 101,903 |
| 2026 | 65,119 | 24,259 | 89,378 |
| 2027 | 68,499 | 22,350 | 90,849 |
| 2028 | 59,106 | 22,838 | 81,944 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

**TABELA E BUXHETIT SIPAS AKTIVITETEVE TË SHPENZIMEVE PËR ARSIMIN BAZË DHE PARASHKOLLOR (2025–2028)**

| Aktiviteti i shpenzimit | Viti 2025 Në mijë lekë | Viti 2026 Në mijë lekë | Viti 2027 Në mijë lekë | Viti 2028 Në mijë lekë | Shuma sipas aktiviteteve |
|---|---|---|---|---|---|
| Paga, sigurime shoqërore për personelin arsimor në institucionet e arsimit bazë dhe parashkollor (edukator dhe punonjës të shërbimeve mbështetëse) **(600)** | 51,328 | 48,524 | 50,716 | 51,210 | 201,778 |
| Shpenzime operative korrente dhe mirëmbajtje **(602)** | 9,844 | 8,456 | 7,783 | 7,896 | 33,979 |
| Investime kapitale në infrastrukturë arsimore **(231)** | 6,543 | 8,139 | 10,000 | | 24,682 |
| **Shuma sipas viteve** | 67,715 | 65,119 | 68,499 | 59,106 | 260,439 |

**TABELA E BUXHETIT SIPAS AKTIVITETEVE TË SHPENZIMEVE – Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm (2025–2028)**

| Aktiviteti i shpenzimit | Viti 2025 Në mijë lekë | Viti 2026 Në mijë lekë | Viti 2027 Në mijë lekë | Viti 2028 Në mijë lekë | Shuma sipas aktiviteteve |
|---|---|---|---|---|---|
| Paga, Sigurime shoqërore për personelin e shërbimeve mbështetëse në institucionet e arsimit të mesëm të përgjithshëm (punonjës të shërbimeve mbështetëse) **(600)** | 12,696 | 15,635 | 13,855 | 14,000 | 56,186 |
| Shpenzime operative dhe mirëmbajtje **(602)** | 6,235 | 6,970 | 6,742 | 6,852 | 26,799 |
| Investime kapitale në infrastrukturë arsimore **(231)** | 15,257 | 1,654 | 1,753 | 1,986 | 20,650 |
| **Shuma sipas viteve** | **34,188** | **24,259** | **22,350** | **22,838** | 103,635 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

## 6. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)

**Qëllimi 1 (Q1) Rritja e aksesit dhe cilësisë së infrastrukturës arsimore, garantimi i kushteve themelore në institucionet parauniversitare dhe forcimi i kapaciteteve menaxheriale.**

**Objektivi O1.1 Deri në fund të vitit 2028, të sigurohet funksionimi i qëndrueshëm dhe cilësor i të gjitha kopshteve dhe shkollave në territorin e Bashkisë, përmes: (i) angazhimit dhe mbështetjes së vazhdueshme të personelit edukativ dhe mbështetës; dhe (ii) garantimit të ofrimit të shërbimeve bazë (ujë të pijshëm, energji elektrike, sistem ngrohjeje, higjienë, transport, pajisje didaktike dhe mirëmbajtje infrastrukture), në të gjitha njësitë administrative.**

| Aktivitete | Periudha e zbatimit | Përgjegjës | Partnerë | Burimet financiare | Treguesit e matjes së progresit |
|---|---|---|---|---|---|
| **Mbështetje financiare dhe sigurime shoqërore për stafin arsimor edukator dhe stafin e shërbimeve mbështetëse**<br><br>*Garantimi i fondeve të nevojshme për pagesat mujore, kontributet shoqërore dhe shëndetësore të stafit arsimor dhe ndihmës me synim ruajtjen e vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimit:*<br><br>*32 edukatore/drejtues dhe*<br>*3 mësues ndihmës për kopshtet;*<br>*3 staf i qendrës kulturore të fëmijëve;*<br>*Konvikti "Kosova"6 staf-1 përgjegjës, 1 kujdestare, 1* | 2026–2028 | Njësia përgjegjëse për arsimin;<br>Njësia përgjegjëse për buxhetin dhe financat | Këshilli Bashkiak<br>Kryetari i bashkisë | Transfertë specifike + Buxhet vendor<br>Perfshire ne zerin "*Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli*" dhe "*Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore*" | • Numri i kopshteve të mbështetura me staf edukativ dhe mbështetës;<br>• Numri i personelit edukativ në arsimin parashkollor<br>• Numri i stafit për shërbimet mbështetëse në institucionet arsimore parashkollore (roje, pastrues, ndihmës teknikë, etj.)<br>• Raporti i mësuesve ndihmës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte<br>• Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte<br>• Numri i fëmijëve rom dhe egjiptianë të regjistruar në kopshte<br>• Ndryshimi vit pas viti në % i numrit të fëmijëve rom dhe egjyptian të regjistruar në koshte |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| *kuzhiniere, 1 ndihmës-kuzhiniere, 1 mgaziniere, 1 punonjës lavanderie)*<br>*19 punonjës sanitarë),*<br>*6 roje,* | | | | | • Numri i fëmijëve të regjistruar në shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm<br>• Numri i fëmijëve rom dhe egjiptianë të regjistruar në shkolla;<br>• Ndryshimi vit pas viti në % i numrit të fëmijëve rom dhe egjyptian të regjistruar (që frekuentojne) në shkolla<br>• Raporti edukator për fëmijë në kopsht;<br>• Numri mesatar i fëmijëve për grup<br>• Numri mesatar i fëmijëve për grup në parashkollor (klasa pergatitore)<br>• Numri i shkollave të mbështetura me staf mbështetës<br>• Numri i stafit mbështetës në institucionet arsimore shkollore (roje, pastrues, ndihmës teknikë, etj.)<br>• Numri mesatar i nxënësve për klasë në arsimin bazë<br>• Numri i fëmijëve të akomoduar pranë Konviktit "Kosova"<br>• Shpenzime për shërbime mbështetëse për nxënës (në mijë lekë) |
| **Mirëmbajtja e planifikuar dhe reagimi emergjent**<br><br>*Realizimi i punimeve të rregullta të riparimit dhe inspektimeve periodike të infrastrukturës shkollore dhe parashkollore, si dhe krijimi i një financimi emergjent për nderhyrje të menjëhershme në rast prishjesh* | 2026–2028 | Njësia përgjegjëse për arsimin;<br>Njësia përgjegjëse për administrimin e brimeve njerëzore | Këshilli Bashkiak<br>Kryetar i Bashkisë | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike Perfshire ne zerin "Shpenzime operative dhe mirëmbajtje" | • Numri godinave të arsimit (parashkollor, 9- vjeçar, i mesëm) ku janë bërë ndërhyrje të mirëmbajtjes |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| *ose fenomeneve natyrore. (mirëmbajtje të lehta, teknike, elektrike, pajisje, Lyerje, ndarje ambientesh, mirëmbajtje kaldajash, elektroshtepiakesh, kompjuterash, printerash, pajisjesh të zyrave)*<br>- *20 Kopshte*<br>- *19 Shkolla*<br>- *Qendra Kulturore e fëmijëve (QKF)*<br>- *Konvikti "Kosova"* | | | | | |
| **Menaxhimi i shërbimeve të pastrimit dhe higjienës**<br><br>*Vendosja e standarteve për pastrim ditor, higjienë personale dhe ambientale në institucionet arsimore, trajnimi i stafit sanitar dhe kontroll i zbatimit të protokolleve sanitare për:*<br>- *20 Kopshte*<br>- *19 Shkolla*<br>- *QKF*<br>- *Konvikti "Kosova"* | 2026–2028 | Njësia përgjegjëse Njësia përgjegjëse për shërbimet publike | Shkollat, operatorë të higjienës, kopshtet | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "Shpenzime operative dhe mirëmbajtje" | • Nr. i shkollave me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare<br>• Nr. i kopshteve me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare |
| **Funksionimi i sistemeve të ngrohjes dhe energjisë**<br><br>*Sigurimi dhe monitorimi i sistemeve efikase të ngrohjes, me* | 2026–2028 | Njësia përgjegjëse për arsimin,<br>Njësia përgjegjëse për shërbimet | Operatorë të energjisë, | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "Shpenzime | • Nr. i institucioneve arsimore parashkollre, te arsimit bazë dhe atij të mesëm me sistem funksional ngrohjeje<br>• Numri i shkollave qëngrohen me dru |

-REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA HAS

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| *fokus eficiencën energjetike dhe sigurinë teknike, për të garantuar komoditetin termik në sezonin e ftohtë për:*<br>- *20 Kopshte*<br>- *19 Shkolla*<br>- *QKF*<br>- *Konvikti "Kosova"* | | publike | | operative dhe mirëmbajtje" | zjarri Numri i shkollave që ngrohen me kaldaja dhe naftë dhe gaz<br>• Sigurimi i ngrojes për QKF;<br>• Sigurimi i ngrohjes për Konviktin "Kosova" |
| **Furnizimi me materiale dhe logjistikë didaktike**<br><br>*Pajisja e rregullt me kancelari, materiale didaktike, mjete vizatimi, libra dhe lodra edukuese, të standardizuara sipas grupmoshave dhe niveleve të arsimit.*<br><br>*Progresivisht bashkia do të rrisë mbështetjen me materiale didaktike për kopshtet* | 2026–2028 | Njësia përgjegjëse për arsimin | Shkollat | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "Shpenzime operative dhe mirëmbajtje" | • Nr. i institucioneve të arsimit parauniversitar të furnizuara me kancelari dhe logjistikë didaktike (sipas llojit, ciklit të arsimit) |
| **Siguria fizike dhe mbrojtja nga zjarri**<br><br>*Kontroll i periodizuar dhe kolaudim i paisjeve kundër zjarrit, përditësimi i planit të evakuimit, trajnimi i stafit dhe ushtrime simulimi me pjesëmarrjen e fëmijëve dhe stafit për:* | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin<br>Zyra e Emergjencave<br>Shërbimi zjarrëfikës | Zjarrfikësja, NjA | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "Shpenzime operative dhe mirëmbajtje" | • Nr. i fikseve të vendosura dhe funksionale në institucionet arsimore parauniversitare;<br>• Nr. i institucioneve arsimore parauniversitare (sipas llojit, ciklit arsimor) në kushte të sigurta përsa i përket pajisjes me fikse zjarri;<br>• Numri i shkollave me shërbim sigurie; |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| - *20 Kopshte*<br>- *19 Shkolla*<br>- *QKF*<br>- *Konvikti "Kosova"* | | | | | |
| **Menaxhimi i dokumentacionit administrativ të institucioneve**<br><br>*Prokurimi dhe shpërndarja e formularëve, regjistrave dhe librave zyrtarë për administrimin arsimor dhe ruajtjen e transparencës për:*<br><br>- *20 Kopshte*<br>- *19 Shkolla*<br>- *QKF*<br>- *Konvikti "Kosova"* | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin;<br>Njësia përgjegjëse për buxhetin dhe financat | Shkollat | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "Shpenzime operative dhe mirëmbajtje" | • Nr. i shkollave/kopshteve/institucioneve të arsimit të pajisura me dokumentacion |
| **Sigurimi i ushqimit të shëndetshëm në institucionet parashkollore**<br><br>*Planifikimi, gatimi dhe shpërndarja e vakteve të balancuara në një kopësht (Kopshti 1 "qershori" bazuar në dietën e duhur dhe kontroll higjeno-sanitar.* | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin;<br>Njësia përgjegjëse për buxhetin dhe financat<br>Njësia përgjegjëse rajonale për Shëndetin Publik | Operatorët e licencuar, Ministria e Arsimit, Sportit (MAS) | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "Shpenzime operative dhe mirëmbajtje" | • Numri i kopshteve me dreke |
| **Dezinfektimi dhe kontrolli sanitar periodik**<br><br>*Planifikimi i shërbimeve të dezinfektimit, deratizimit dhe* | 2026–2028 | Njësia përgjegjëse për arsimin<br>Njësia përgjegjëse për shërbimet | Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), operatorë të kontraktuar | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin "*Shpenzime* | • Nr. i dezinfektimeve të kryera në vit në secilin institucion arsimor parauniversitar; |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| *dezinsektimit në institucionet arsimore, veçanërisht në fillim dhe fund sezoni.*<br><br>- *20 Kopshte*<br>- *19 Shkolla*<br>- *QKF*<br>- *Konvikti "Kosova"* | | publike | | *Korrente, Mallra dhe sherbime"*+ fond emergjence | |
| **Mbështetje logjistike dhe teknike për shërbime për institucionet arsimore**<br><br>*Vënia në dispozicion e mjeteve të transportit dhe logjistikës ndihmëse (transport personeli manaxherial dhe administrative i sherbimit, kontenier, paisje për ngarkim-shkarkim, etj) sipas nevojave të raportuara nga institucionet në terren.* | Çdo vit | Njësia përgjegjëse për arsimin, | Njësia përgjegjëse për shërbimet publike | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Perfshire ne zerin sherbim transporti ne "*Shpenzime operative dhe mirëmbajtje"* | • Shpenzime për karburant, siguracione, pjesë këmbimi për automjete të shërbimit të DA, dhe mbështetje për administratën |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · BASHKIA HAS

| **Objektivi O1.2 Deri në fund të vitit 2028, të realizohen ndërhyrje rikonstruksioni në të paktën 3 institucione arsimore (kopshte dhe shkolla), përfshirë përmirësime strukturore, teknike dhe estetike, si dhe pajisjen e tyre me inventar funksional dhe mjete didaktike, me qëllim përmirësimin e kushteve mësimore dhe përputhshmërinë me standardet kombëtare të cilësisë.** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitete** | **Periudha e zbatimit** | **Përgjegjës** | **Partnerë** | **Burimet financiare** | **Tregues** |
| **Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit parashkollor:** | | | | | |
| *Rikonstruksioni i Kopshtit 1 "Qershori"*<br>Ndertim nje ambjenti për kopësht (zgjerim i hapesires) në Shkollen" Rexhep Hoxha"Tegtan.<br>Ndërtimi i një kopështi në fshatin Liqeni-Kuq Fajza, me kërkes të kryesisë së fshatit. | 2026 -2028 | Njësia përgjegjëse për arsimin, | Qeveria Shqiptare;<br>Donatorë | Buxhet Qedror;<br>Donatorë | • Nr. i institucioneve të edukimit të hershëm ( kopshte të rikonstruktuara;<br>• Përmirësim i kushteve sipas standarteve |
| **Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit:** | | | | | |
| Rikonstruksioni i Gjimnazit "Skënderbeu"<br>Rikonstruksioni i Shkollës 9-vjeçare "Sejdi Dida" | 2026 | Njësia përgjegjëse për arsimin,<br>Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet<br>Njësia përgjegjëse | Bashkia | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike | • Nr. i institucioneve të arsimit bazë të rikonstruktuara;<br>• Nr. i institucioneve të arsimit të mesëm të rikonstruktuara;<br>• Përmirësim i kushteve sipas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | për buxhetin dhe menaxhimin financiar | | | standarteve |

| **Objektivi O1.3 Deri në fund të vitit 2028, të zhvillohet dhe vihet në funksion një regjistër elektronik i menaxhimit të informacionit arsimor për të gjitha institucionet arsimore të Bashkisë, duke trajnuar të paktën 90% të stafit administrativ dhe drejtues për përdorimin e tij, dhe duke siguruar raportim të rregullt vjetor mbi performancën e sistemit arsimor në nivel njësish administrative.** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitete** | **Periudha e zbatimit** | **Përgjegjës** | **Partnerë** | **Burimet financiare** | **Tregues** |
| **Zhvillimi dhe ndërtimi regjistrit elektronik të menaxhimit të informacionit arsimor**<br><br>*Hartimi dhe zbatimi i nje platforme regjistër elektronik të centralizuar për regjistrimin, monitorimin dhe analizimin e të dhënave mbi frekuentimin, burimet njerëzore, nevojat infrastrukturore dhe performancën e shërbimit në institucionet arsimore.* | 2026 - 2028 | Njësia përgjegjëse për arsimin,<br>Shërbimi IT në bashki; | Donatorë, OSHC | Buxheti i Bashkisë, Donatorë (IADSA, IPA) | • Regjistër eletronik funksional në përdorim;<br>• Të dhëna të aksesueshme dhe të analizuara në nivel njësish administrative |
| **Trajnimi i stafit administrativ dhe drejtues për përdorimin e regjistrave digjitalë**<br><br>*Organizimi i sesioneve trajnimi dhe orientimi mbi përdorimin e sistemeve të reja të menaxhimit të informacionit dhe raportimit në kohë reale.* | 2026 - 2028 | Njësia përgjegjëse për arsimin,<br>Shërbimi IT në bashki; | Donatorë,<br>Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë<br>OSHC | Buxheti i bashkisë, bashkëpunime me donatorë | • Numri i trajnimeve të realizuara;<br>• Numri i punonjësve të trajnuar;<br>• Vlerësimi i kapaciteteve të rritura |
| **Hartimi dhe zbatimi i planit vjetor të raportimit të** | 2026 - 2028 | Njësia përgjegjëse | Kryetar i | Buxheti i bashkisë, bashkëpunime me | • Raport vjetor i miratuar dhe publikuar; |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **performancës arsimore**<br><br>*Monitorimi i treguesve të matshëm dhe objektivë të performancës së shkollave dhe kopshteve, dhe publikimi i raporteve periodike në nivel bashkie.* | | për arsimin,<br>Njësia e Menaxhimit dhe monitorimit të performancës në bashki | Bashkisë<br>Këshilli bashkiak | donatorë | • Indikatorë të strukturuar sipas objektivave të zhvillimit/përmirësimit të shërbimit |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

**Qëllimi 2 (Q2)** – **Rritja e cilësisë së edukimit dhe garantimi i përfshirjes së barabartë të fëmijëve në sistemin parauniversitar.**

| **Objektivi O2.1 Deri në fund të vitit 2028, të sigurohet zhvillimi profesional i të paktën 90% të edukatorëve dhe mësuesve të ciklit parashkollor në Bashki, përmes realizimit të cikleve trajnimi mbi qasjet bashkëkohore pedagogjike dhe përdorimin e materialeve didaktike të unifikuara, me synim përmirësimin e praktikave mësimore dhe cilësisë së mësimdhënies.** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitete** | **Periudha e zbatimit** | **Përgjegjës** | **Partnerë** | **Burimet financiare** | **Tregues** |
| **Unifikimi i pajisjeve didaktike, për kopshtet** | Çdo vit | Njësia përgjegjesë për arsimin, | MAS, partnerë zhvillimi<br>ASKAP | Buxhet vendor + transfertën e pakushtëzuar specifike<br>Organizara partnere të tjera<br>Bshkëpunim me bizneset dhe prindërit | • Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) që përfitojnë nga mjetet didaktike |
| **Fuqizimi i kapaciteteve të stafit arsimor të institucioneve parashkollore, në funksion të garantimit të një edukimi cilësor dhe mbështetës për zhvillimin e hershëm të fëmijëve.** | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin, | MASR, institucionet arsimore, OSHC, ASKAP | Buxhet vendor + transfertën e pakushtëzuar specifike përfshirë në zërin "*Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli*" dhe "*Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore*" | • Nr. (përqindja) i edukatorëve të trajnuara;<br>• Nr. i trajnimeve të realizuara; Nr. i tematikave të përzgjedhura nga vetë stafi i edukatoreve;<br>• Përmirësimi i praktikave të mësimdhënies; |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

| **Objektivi O2.2 Deri në fund të vitit 2028, Bashkia Has do të sigurojë angazhimin e mësuesve ndihmës dhe shërbimit psiko-social në të gjitha kopshtet publike, duke garantuar: (i) një mësues ndihmës për çdo 2-3 fëmijë me aftësi të kufizuara; (ii) praninë e psikologut ose punonjësit social në secilin institucion; dhe (iii) ofrimin e mbështetjes së strukturuar për 100% të rasteve të referuara të fëmijëve nga grupet vulnerabël, nëpërmes angazhimit të stafit të kualifikuar dhe bashkëpunimit me strukturat vendore e partnere.** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitete** | **Periudha e zbatimit** | **Përgjegjës** | **Partnerë** | **Burimet financiare** | **Tregues** |
| **Angazhimi i mësuesve ndihmës në kopshte**<br>• *3 mësues ndihmës në vitin 2025* | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin,<br>Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore | OJQ sociale, MAS | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike përfshirë në zërin "*Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli*" dhe "*Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore*" | Raporti i mësuesve ndihmës ndaj numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore parashkollore<br>- 1 mësues ndihmës për çdo **2-3** fëmijë me aftësi të kufizuara në vitin 2026;<br>- 1 mësues ndihmës për çdo **2-3** fëmijë me aftësi të kufizuara në vitin 2027;<br>- 1 mësues ndihmës për 2-3 fëmijë me aftësi të kufizuara në vitin 2028; |
| **Ngritja dhe fuqizimi i shërbimit psiko-social në institucionet parashkollore në varësi të Bashkisë**<br>• *Në Bashkinë Has për shërbimin e arsimit parashkollor* | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin,<br>Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore;<br>Njësia përgjegjëse për shërbimet | Kopshtet;<br>OSHC | Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor) | Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) të mbështetur me shërbim psiko social;<br>- Viti 2026: Të angazhohen psikologë dhe punonjës socialë në 20 kopshte (me |

| | | |
|---|---|---|
| *parashikojmë të angazhojmë psikologe dhe punonjëse sociale.00* | sociale | prioritet zonat urbane dhe Njësitë Administrative me risk social më të lartë);<br>- Viti 2027: Shtrirja e shërbimit në 20 kopshte në territorin e bashkisë;<br>- Viti 2028: Të mbulohen të gjitha 20 kopshtet përmes kombinimit të psikologëve dhe punonjësve socialë. |
| | | Numri i rasteve të ndjekura në mënyrë të strukturuar për fëmijët nga grupe vulnerabël<br>- **Viti 2026**: 100% raste të referuara të ndjekura;<br>- **Viti 2027**: 100% raste të referuara të ndjekura;<br>- **Viti 2028**: 100% raste të referuara të ndjekura; |
| | | Numri i takimeve me prindërit të organizuara nga shërbimi psiko-social<br>- **Viti 2026:** 49 takime me teme të përcaktuar: Minimalisht 1 takim për çdo kopsht (takime shtesë sipas nevojës)<br>- **Viti 2027:** 49 takime me teme të përcaktuar: |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Minimalisht 1 takim për çdo kopsht (takime shtesë sipas nevojës)<br>- **Viti 2028:** 49 takime me teme të përcaktuar: Minimalisht 1 takim për çdo kopsht (takime shtesë sipas nevojës) |
| **Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë** | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin;<br>Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale | Shkollat, Njësitë Administrative, OJQ<br>Këshilli bashkiak | Buxhet vendor + donacione + projekte sociale | - Nr. i nxënësve (vajza/djem) nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel të mbështetur;<br>- Nr. i nxënësve të arsimit professional për të cilët miratohet nga Këshilli bashkiak mbështetja me bursë<br>- Viti 2026: 100% raste të nxënësve referuara të ndjekura dhe të mbështetura;<br>- Viti 2027: 100% raste të nxënësve referuara të ndjekura dhe të mbështetura; |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | - Viti 2028: 100% raste të nxënësve referuara të ndjekura dhe të mbështetura;<br>- Mbështetje e integruar:me bursë; materiale, ndihmë sociale, përfshirje në aktivitete. |
| **Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkëlqyera** | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin;<br>Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale | MAS, mësues, komuniteti | Buxhet vendor + shpërblime nga MAS | - Nr. i nxënësve (vajza/djem) me rezultate të shkëlqyera të mbështetur; |

-REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA HAS

**Objektivi O2.3 Të sigurohet deri në fund të vitit 2028 funksionalizimi i strukturave përfaqësuese në të gjitha institucionet arsimore parauniversitare të bashkisë, përmes krijimit, trajnimit dhe aktivizimit të bordeve, këshillave të prindërve dhe komisioneve të shëndetit e sigurisë, duke rritur bashkëpunimin efektiv ndërmjet shkollës/kopshtit, familjes dhe komunitetit lokal në të paktën 90% të shkollave dhe kopshteve.**

| Aktivitete | Periudha e zbatimit | Përgjegjës | Partnerë | Burimet financiare | Tregues |
|---|---|---|---|---|---|
| **Themelimi dhe funksionalizimi i bordeve në institucionet arsimore (parashkollore dhe shkollore) dhe komunitetit**<br>• *Hartimi i rregullores se funksionimit te bordeve ne cdo kopsht dhe shkolle.*<br>• *Zgjedhja e anetareve perfaqesues nga prinderit, komuniteti dhe stafi arsimor.*<br>• *Takime periodike te bordeve me drejtuesit e institucioneve per planifikim dhe vendimmarrje te perbashket.* | 2026–2028 | Njësia përgjegjëse për arsimin | Administratorët e Njësive Administrative; këshilli bashkiak;<br>Kryetar i Bashkisë<br>Kopshtet; Prindërit | Fondi i pagave (buxheti vendor) | Nr. Bordeve të shkollave të institucionalizuar dhe funksionalë (urbane, NjA);<br>Nr. Bordeve të kopshteve të institucionalizuar dhe funksionalë (urbane, NjA);<br>Pjesëmarrja e balancuar gjinore e prindërve (nënë/baba) në strukturat menaxhuese të kopshteve dhe shkollave; |
| **Institucionalizimi dhe Këshillit të Prindërve dhe Komisionit të Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në institucionet e arsimit** | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin | Administratorët e Njësive Administrative; këshilli bashkiak;<br>Kopshtet; | Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor) | Struktura menaxhuese në kopshte dhe shkolla aktive<br>Pjesëmarrja e balancuar |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **parashkollor (kopshte)** | | | Prindërit | | gjinore e prindërve (nënë/baba) në strukturat menaxhuese të kopshteve dhe shkollave |
| **Organizimi i "Ditëve të Hapura" në shkolla dhe kopshte**<br><br>• Planifikimi i aktiviteteve prezantuese të arritjeve të nxenesve dhe institucioneve.<br>• Ftesa për prinder, komunitet dhe partnerë lokale për vizitë dhe diskutime. | 2026–2028 | Njësia përgjegjesë për arsimin<br><br>Drejtuesit e kopshteve dhe shkollave | ZVAP | Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor) | Nr. i aktiviteteve të ditëve të hapura të organizuara në kopshte dhe shkolla; |
| **Nxitja e përfshirjes së këshillave të prindërve dhe organizatave komunitare lokale** në proceset vendimmarrëse, planifikuese dhe monitoruese të shërbimit arsimor, me qëllim rritjen e transparencës dhe bashkëpunimit | 2026 - 2028 (proces i vazhdueshëm) | Njësia përgjegjesë për arsimin<br><br>Drejtuesit e kopshteve dhe shkollave | Bordi i Shkollës, Bordi i kopshtit, Këshillat e Prindërve, Komuniteti lokal | Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor) | Përqindja (%) e prindërve që marrin pjesë rregullisht në takimet e këshillave të prindërve<br><br>Numri i propozimeve të bëra nga prindërit/këshillat e prindërve që janë reflektuar në planet vjetore të institucionit |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

**Qëllimi 3 (Q3)– Fuqizimi dhe zhvillimi gjithëpërfshirës i fëmijëve përmes nxitjes së aftësive krijuese, sociale dhe sipërmarrëse, nëpërmjet programeve jashtëkurrikulare edukative, kulturore, sportive dhe teknologjike, në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Fëmijëve dhe komunitetin.**

| **Objektivi O3.1** Të rritet me të paktën 30% deri në vitin 2028 pjesëmarrja e fëmijëve dhe të rinjve në institucionet arsimore të Bashkisë Has në aktivitete jashtëkurrikulare, kulturore, sportive, artistike dhe sociale, përmes organizimit vjetor të të paktën 10 aktiviteteve për çdo institucion arsimor, duke përfshirë të paktën 70% të fëmijëve të regjistruar, përfshirë vajza dhe fëmijë nga grupe vulnerabël. | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitete** | **Periudha e zbatimit** | **Përgjegjës** | **Partnerë** | **Burimet financiare** | **Tregues** |
| **Organizimi i programeve edukative, kulturore dhe sportive dhe të teknologjisë për fëmijët e arsimit parauniversitar në Bashkinë Has, nëpërmjet partneritetit me QKF** | Çdo vit | Qendra Kulturore e Fëmijëve<br>Shkollat/kopshtet | Prindër, OJQ, MAS | Buxhet vendor, mbështetje donatorësh; | Numër dhe larmi aktivitetesh; përfshirje gjithëpërfshirës; |
| **Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojëra edukative dhe mbështetje emocionale në institucionet e Arsimit:** | Çdo vit sipas kalendarit të aktiviteteve të miratuara në planin e institucioneve arsimore | Shkollat/kopshtet | Prindër, OJQ, MAS | Buxhet vendor, mbështetje donatorësh | Numër dhe larmi aktivitetesh; përfshirje gjithëpërfshirëse; |
| **1.** **23–30 Shtator** – Java Evropiane e Sportit<br>- Loja sportive në oborrin e kopshtit (loja popullore)<br>- Ushtrime në natyrë (gimnastikë)<br>- Loja të ndryshme lëvizore, Gara me biçikleta, etj.) | | | | | |
| **2.** Prill–Maj – Java Olimpike<br>- Loja të ndryshme sportive (stafeta me flamuj, topa) | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

- Gara vrapimi, midis kopshteve në grupe
- Gara me biçikleta

3. 20 Nëntor – Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve
   - Bisedë, postera, aktivitete në natyrë (Kam të drejë të luaj)
   - Ekspozitë me materiale të përgatitura nga fëmijët "Të drejtat e mia"
   - "Unë mbroj të drejtat e mia" (bisedë)

4. Dita e Luftës Kundër Bullizmit (21 nëntor)
   - Bisedë me fëmijët

1. Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe
   - Postera me gjuhën shqipe & ilustrime
   - Koncert për gjuhën shqipe (Gjuha jonë sa e mirë)

2. Dita Ndërkombëtare e Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (3 dhjetor)
   - Biseda sensibilizuese për fëmijët me nevoja të veçanta
   - Loja me role (si t'i ndihmojmë shokët me nevoja të veçanta)
   - Ekspozitë me punime të përgatitura nga fëmijët me AK

3. Dita Botërore e Gjuhës Amtare
   - Vizitë në bibliotekë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

**4.** Dita Botërore e Ujit (UNESCO 22 mars)

- Rëndësia dhe vlerat e ujit (bisedë, prezantime)
- "Uji është jetë" (Postera, eksperiment me ujëra)
- Bisedë për vlerat e ujit

**5.** Dita Ndërkombëtare e Romëve

- Bisedë për fëmijët romë

**6.** Zakonet dhe traditat e romëve

**7.** Dita Botërore e Librit (23 prill)

- Ne dimë të bëjmë libra (aktivitet krijues)
- Vizitë në bibliotekë
- Dhuro një libër, hap një dritare (fushatë sensibilizuese)

**8.** Dita Botërore e Mjedisit (5 qershor)

- Ekspozitë me mjete të riciklueshme
- Mbrojmë tokën, planetin tonë (projekt)
- Mbjellim lule në oborrin e kopshtit ose në vazo (aktivitet praktik)
- Mbajmë pastër mjedisinku mësojmë e luajmë (aktivitet praktik, bisedë)
- Ekskursion në lulishten e qytetit

**9.** Yjet e Vallzimit

- Konkurs midis kopshteve të qytetit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

| **Objektivi specific O3.2 Të vendosen deri në fund të vitit 2028 të paktën 10 partneritete funksionale me institucione kulturore, organizata të shoqërisë civile dhe aktorë komunitarë, me qëllim organizimin çdo vit të të paktën 15 aktivitete edukative, kulturore dhe sociale në institucionet arsimore të Bashkisë Has, duke siguruar pjesëmarrjen e të paktën 70% të fëmijëve të regjistruar në shkolla e kopshte.** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitete** | **Periudha e zbatimit** | **Përgjegjës** | **Partnerë** | **Burimet financiare** | **Tregues** |
| **Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojëra edukative dhe mbështetje emocionale në institucionet e Arsimit:** | Çdo vit | Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Prindër, OJQ | Buxhet vendor, mbështetje donatorësh | Numër dhe larmi aktivitetesh; përfshirje gjithëpërfshirëse |
| **1.** Vizita në bibliotekë (për Ditën e Gjuhës Amtare dhe Ditën e Librit) | Shkurt & Prill | Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Biblioteka, Bashkia, Drejtoria Rajonale e Kulturës | Buxhet shkollor, mbështetje nga institucionet kulturore | Numri i vizitave në bibliotekë; pjesëmarrja e fëmijëve |
| **2.** Ekskursione edukative dhe aktivitete komunitare. | Çdo vit | Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Prindër, OJQ | Buxhet vendor, mbështetje donatorësh | Numër dhe larmi aktivitetesh; përfshirje gjithëpërfshirëse |
| **3.** Fushata "Dhuro një libër, hap një dritare" (me bashkëpunimin e institucioneve kulturore) | Prill | Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Qendra Kulturore, Biblioteka, Prindër | Mbështetje donatorësh, Buxhet vendor | Numri i librave të dhuruar; numri i fëmijëve të përfshirë |
| **4.** "Pedalo për turizëm dhe kulturë" – aktivitet në hapësira publike me mbështetjen e institucioneve vendore<br>- Pedalim me biçikleta në pedonalen e | Maj–Qershor | Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Bashkia, Drejtoria e Kulturës, Policia Bashkiake | Bashkia, partnerë lokalë | Numri i fëmijëve pjesëmarrës; numri i punimeve ekspozuar |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| qytetit<br>- Ekspozitë me punime, vizatime dhe postera | | | | | |
| **5.** "Pedalo Kuq" – marshim festiv me bashkëpunim ndërsektorial për Festat Kombëtare | Nëntor | Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Bashkia, Drejtoria e Arsimit, Policia Bashkiake, MAS | Buxhet vendor, sponsorizime private | Numri i pjesëmarrësve; vlerësim nga prindërit dhe publiku |
| **6.** "Adopto një pemë, ruaj lagjen tënde"- Fëmijët dhe nxënësit adoptojnë një pemë për t'u kujdesur gjatë vitit. | Gjatë vitit | Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Drejtoria e Gjelbërimit, OJF mjedisore, shkollat | Buxhet vendor, sponsorizime private | Numri i pjesëmarrësve; vlerësim nga prindërit dhe publiku |
| **7.** "Javët e riciklimit" në shkolla dhe kopshte<br>Partnerë - Grumbullim mbetjesh, ekspozita me punime nga materiale të ricikluеshme. | Gjatë vitit | Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Shoqata mjedisore, Ndërmarrja e Pastrimit, NVM të riciklimit | Buxhet vendor, sponsorizime private | Numri i pjesëmarrësve; vlerësim nga prindërit dhe publiku |
| **8.** "Uji është jetë" – Projekti ndërshkollor për ruajtjen e ujit-Panele informuese, posterë, eksperimente në klasë dhe vizita në impiante. | Gjatë vitit | Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Ujësjellësi ISHP, ZVA | Buxhet vendor, sponsorizime private | Numri i pjesëmarrësve; vlerësim nga prindërit dhe publiku |
| **9.** "Energjia që duam" – Javë edukimi për eficiencën energjetike - Lojëra me tematikë energjie, mini-projekte të klasave për kursim të energjisë. | Gjatë vitit | Arsimit dhe Institucionet Arsimore | OSHEE, ERE, organizata rinore të teknologjisë | Buxhet vendor, sponsorizime private | Numri i pjesëmarrësve; vlerësim nga prindërit dhe publiku |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

## 7. Plani i investimeve kapitale

Lista e projekteve të investimeve në arsimin parauniversitar për periudhën afatmesme 2026 -2028 (në mijë lekë) përfshin projektet do të financohen nga Buxheti i bashkisë Has

| Titulli i Projektit | Vlera totale e projektit (në mijë lekë) | Viti 2024 | Viti 2025 | Viti 2026 | Viti 2027 | Viti 2028 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Rikonstruksioni i Gjimnazit "Skënderbeu" | 113,400 | | | | | |
| Supervizimi i punimeve për Gjimnazin Skënderbeu | 1,236 | | | | | |
| Rikonstruksioni i Shkollës 9-vjeçare "Sejdi Dida" | 151,162 | | | | | |
| Supervizimi i punimeve për shkollën "Sejdi Dida" | 1,830 | | | | | |
| Kolaudimi i punimeve për shkollën "Sejdi Dida" | 177 | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

## 8. Monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

### Indikatorët e Performancës

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjikë. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktivitetesh në planin e veprimit dhe do të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm. Këta përfshijnë:

- Numrin e institucioneve të rikonstruktuara ose me kushte të përmirësuara;
- Numrin i kopshteve (hapësirave) të reja funksionale;
- Rritjen e regjistrimeve në kopshte dhe përfshirjen e fëmijëve nga grupe në nevojë;
- Numrin e mësuesve dhe edukatorëve të trajnuar;
- Cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e mjeteve didaktike dhe teknologjisë;
- Numrin e aktiviteteve jashtëmësimore dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në to;
- Mbështetjen sociale për fëmijët në nevojë (ushqim, mjete, shërbime psiko-sociale);
- Efiçienca në furnizim, mirëmbajtje dhe shërbime mbështetëse.

### Planifikimi i vlerësimit të progresit

Progresi i planit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të integruar në ciklin e planifikimit buxhetor dhe vendimmarrjes vendore. Vlerësimi do të përfshijë:

- Raportime vjetore mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- Matjen e ndikimit të investimeve në infrastrukturë dhe cilësi shërbimi;
- Analizën e të dhënave të mbledhura përmes monitorimit në terren;
- Vlerësimin e përmirësimit të qasjes, përfshirjes dhe mjedisit të të nxënit;
- Ndërlidhjen e progresit me planifikimin e ardhshëm afatmesëm.

### Përfshirja e aktorëve të jashtëm

Për të garantuar objektivitetin, transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm, do të sigurohet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm, si:

- Ekspertë të pavarur në fushën e arsimit, të ftuar për të kryer vlerësime tematike;
- Organizata joqeveritare që merren me cilësinë e arsimit dhe përfshirjen sociale;
- Këshillat e prindërve, drejtuesit e shkollave dhe komunitetet vendore;
- Njësitë e statistikës/performabces dhe monitorimit të bashkisë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave;
- Partnerë ndërkombëtarë në kuadër të projekteve të mbështetura financiarisht.

**Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi**

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

- **Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara**
- **Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor**

**Monitorimi i realizimit të aktiviteteve**

Çdo aktivitet i planit do të vlerësohet në bazë të një sistemi pikëzimi nga 0 deri në 10, ku:

**0** – Aktiviteti nuk ka nisur.

**1–9** – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.

**10** – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.

Për secilin objektiv strategjik të planit, do të përcaktohet numri total i pikëve maksimale, duke shumëzuar numrin e aktiviteteve të planifikuara për objektivin përkatës me 10 (p.sh., 5 aktivitete x 10 = 50 pikë maksimale për objektivin).

Gjatë zbatimit, pikët reale të arritura për çdo aktivitet do të regjistrohen, dhe më pas do të përmblidhen në nivel objektivi. Kjo do të mundësojë llogaritjen e përqindjes së realizimit të secilit objektiv në kohë reale:

***Perqindja e realizimit te objektivit= (Pike te realizuara/Piket maksimale)×100***

Ky mekanizëm do të sigurojë një vlerësim të qartë, të matshëm dhe të krahasueshëm për zbatimin e planit përgjatë viteve.

**Vlerësimi i ndikimit në komunitet**

Për të matur ndikimin e aktiviteteve në komunitet, do të monitorohet shkalla e pjesëmarrjes së institucioneve arsimore dhe fëmijëve në zbatimin e tyre.

Për çdo aktivitet do të vendosen targete të matshme:

- Numri i kopshteve dhe shkollave të synuara.
- Numri i fëmijëve të parashikuar për përfshirje (në kopsht dhe shkollë, sipas rastit).

Në përfundim të zbatimit të çdo aktiviteti, do të regjistrohet:

- Numri real i institucioneve që morën pjesë (në kopsht ose shkollë).
- Numri real i fëmijëve të përfshirë.

Në rastet kur aktiviteti synon vetëm një kategori (p.sh. vetëm kopshtet), pjesëmarrja për kategorinë tjetër do të konsiderohet.

Për çdo aktivitet do të llogaritet përqindja e pjesëmarrjes së arritur sipas formulës:

***Perqindja e pjesemarrjes=(Numri real i pjesemarresve/Numri target)×100***

Ky tregues do të ndihmojë në vlerësimin e shkallës së përfshirjes dhe impaktit që ka pasur secili aktivitet në komunitetin arsimor.

## 9. Rishikimi dhe përshtatja e planit

Rishikimi dhe përshtatja e planit janë mekanizma thelbësorë për të siguruar vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e arsimit parauniversitar në Bashkinë Has. Këto procese shërbejnë për të ruajtur koherencën midis objektivave të planit, nevojave reale në terren dhe zhvillimeve të reja institucionale, ligjore apo sociale.

**Procesi i rishikimit**

Rishikimi i planit do të bëhet në mënyrë të strukturuar dhe të paracaktuar, me qëllim që të vlerësohet në mënyrë periodike efektiviteti i masave dhe aktiviteteve të ndërmarra. Planifikohen këto forma rishikimi:

- **Rishikimi vjetor** – i fokusuar në përditësimin e planit të veprimit dhe buxhetit vjetor në funksion të rezultateve dhe ndryshimeve të kontekstit;
- **Rishikimi afatmesëm (në fund të vitit 2027)** – për të analizuar realizimin e objektivave strategjike, performancën e indikatorëve dhe për të orientuar masat për vitin 2028;
- **Rishikime të jashtëzakonshme**, në rast të ndryshimeve madhore (si reformë e kuadrit ligjor, emergjenca, ndryshime buxhetore të rëndësishme).

Ky proces do të kryhet në mënyrë të ndërsektoriale, me pjesëmarrjen e drejtorive përgjegjëse, përfaqësuesve të institucioneve arsimore dhe aktorëve të tjerë vendorë.

**Përshtatja e masave dhe aktiviteteve**

Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga monitorimi dhe vlerësimi i planit, si dhe në konsultimet me komunitetin arsimor, do të ndërmerren përshtatje të nevojshme në:

- **Aktivitete konkrete** – duke përmirësuar përmbajtjen, kohëzgjatjen, mënyrën e zbatimit apo përgjegjësit;
- **Alokimin e burimeve** – në rast se disa fusha kërkojnë më shumë mbështetje për të arritur objektivat;
- **Prioritetet vjetore** – në përputhje me nevojat emergjente të fëmijëve, stafit arsimor apo komunitetit lokal;
- **Metodologjinë e zbatimit** – duke integruar praktikat më të mira dhe rekomandimet e vlerësimeve të jashtme.

Ky fleksibilitet në përshtatje synon të sigurojë që plani të mos mbetet një dokument statik, por të jetë një instrument dinamik, funksional dhe i orientuar drejt rezultateve reale për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Bashkinë Has.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

## 10. Raportimi dhe transparenca

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë raportimi dhe transparence, për të garantuar përgjegjshmëri institucionale dhe përfshirje qytetare në vlerësimin e progresit.

- **Raportimi i progresit** do të realizohet përmes raporteve periodike vjetore, të cilat do të përfshijnë ecurinë e zbatimit të objektivave, sfidat e hasura dhe masat korrigjuese të ndërmarra nga njësitë përkatëse.
- **Përfshirja e publikut** do të sigurohet përmes publikimit të raporteve dhe rezultateve në faqen zyrtare të bashkisë, organizimit të takimeve konsultative me komunitetin dhe mundësimit të pjesëmarrjes qytetare në propozimin dhe vlerësimin e masave për përmirësimin e sistemit arsimor.

## 11. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar

### Kuadri Kushtetues dhe Ligjor i përgjithshëm

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, neni 57, pika 1
- **Ligji Nr. 69/2012**, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me **Ligjin Nr. 48/2018**
- **Ligji Nr. 139/2015**, "Për Vetëqeverisjen 0Vendore"
- **Ligji Nr. 9936/2008**, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"
- **Ligji Nr. 68/2017**, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
- **Ligji Nr. 9632/2006**, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar

### Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)

- **Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020**, "Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare"
- **Udhëzim Nr. 14, datë 10.7.2023**, "Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar"
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 13, datë 10.07.2024**, "Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar"
- **Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018**, "Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor"
- **Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024**, "Për miratimin e Kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit"

### Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve

- **Ligji Nr. 121/2016**, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"
- **Ligji Nr. 18/2017**, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve**, 2021–2025
- **Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014**, "Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë"
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MShMS nr. 658, datë 23.09.2019**, "Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet"

### Shërbimi psiko-Social dhe ërfshirja Sociale

- **Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020**, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar"
- **Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor**, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

## 12. Aneks 2: Lista e kopshteve në Bashkinë Has

| Emri i Kopshtit | Njësia Administrative | Qytet/Fshat |
|---|---|---|
| "Sejdi Dida" | Krumë | Qytet |
| Letaj | Golaj | Fshat |
| Metaliaj | Fajza | Fshat |
| Dobrune | Golaj | Fshat |
| Tregtan | Fajza | Fshat |
| Kopshti "Liman Mazrreku "Vranisht | Fajza | Fshat |
| Shkolla "Sali Hajdari" Helshan | Golaj | Fshat |
| Nikoliq | Golaj | Fshat |
| Demokracia | Gjinaj | Fshat |
| Kopshti Golaj | Golaj | Fshat |
| Zgjeç | Golaj | Fshat |
| Brenog | Fajza | Fshat |
| Kosturr | Golaj | Fshat |
| Perollaj | Golaj | Fshat |
| Kopshti Gajrep | Krume | Fshat |
| "1-Qershori" | Krume | Qytet |
| Kopshti Zahrisht | Krume | Fshat |
| Kopshti Fajza | Fajza | Fshat |
| Demokracia" Domaj | Gjinaj | Fshat |
| Vlahen | Golaj | Fshat |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

## 13. Aneks 3: Lista e shkollave në Bashkinë Has

| Njesia Administrative | Emri i shkolles |
|---|---|
| Fajza | Islam Goçi |
| | Liman Mazrreku |
| | Rexhep Hoxha |
| | Qamil Metalia |
| Krumë | Gjimnazi Skënderbeu |
| | Shkolla 9-vjeçare "Sejdi Dida" Krumë |
| | Pashtrik |
| | ALUSH XHEBEXHIA |
| | Adem Pista00 |
| Gjinaj | Shkolla 9-vjeçare "Sinna Gjini" Gjinaj |
| Golaj | Shkolla fillore Dobrunë |
| | Shkolla fillore Kosturr |
| | Shkolla 9-vjeçare Perollaj |
| | Shkolla 9-vjeçare Zgjeç |
| | Shkolla 9-vjeçare "Sali Hajdari" Helshan |
| | Shkolla 9-vjeçare Letaj |
| | Shkolla 9-vjeçare "Rexh Bjraktari" Vlahen |
| | Shkolla 9-vjeçare Nikoliq |
| | Shkolla "Arif Zeqir Brati" Golaj (9-vjecare) |
| | Shkolla "Arif Zeqir Brati" Golaj (gjimnazi) |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS






BASHKIA HAS